



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 45 regjistër (JR)
Datë 23.09.2019

Nr. 3 i vendimit
Datë 26.01.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 26.01.2021, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 45 (JR), datë 23.09.2019, që i përket ankimit:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 154, datë 10.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 62, 63, 64, 65, 66 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; neni F i Aneksit të Kushtetutës, neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 154, datë 10.06.2019, ka vendosur *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, me detyrë gjyqtare/kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
2. Komisioni, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “IKLD”).
3. Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që dispononte për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, Komisioni arriti në përfundimin se:

A. Për vlerësimin e pasurisë

Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, subjekti nuk ka kryer deklarim të saktë të pasurive dhe të interesave privatë, si edhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Ajo është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të saj. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës, i ka parashikuar të tilla që zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato cash) dhe kryerjen e shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si gjyqtare.

B. Për vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. Për rivlerësimin e aftësive profesionale

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

II. Shkaqet e ankimit

4. Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, ka ushtruar ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) kundër vendimit nr. 154, datë 10.06.2019, të Komisionit duke kërkuar ndryshimin/prishjen e këtij vendimi dhe konfirmim në detyrë.

A. Shkaqet ankimore me natyrë procedurale, në mënyrë të përmbledhur:

- i. Komisioni ka kryer shkelje të rënda procedurale gjatë shqyrtimit të çështjes që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, duke filluar që nga faza e hetimit paraprak, gjatë seancës dëgjimore dhe në vendimmarrje.
- ii. Vendimet e Komisionit në këtë çështje janë marrë pa bërë vlerësimin e duhur të provave dhe të argumenteve të rëndësishme që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, të cilat nuk janë adresuar siç duhet.
- iii. Nuk është respektuar parimi i kontradiktoritetit dhe parime të tjera të procesit të rregullt ligjor.
- iv. Subjekti pretendon se është diskriminuar për shkak të përkatësisë në një grup të caktuar sikurse janë ish-të prindjekurit politikë, si dhe për shkak të eksperiencës profesionale duke u konsideruar me përkatësi politike të caktuara.
- v. Nuk janë respektuar garancitë e të akuzuarit në procesin penal.

B. Shkaqet ankimore për vlerësimin e kriterit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur:

- a) Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 85 m², në rr. “{***}”, Tiranë, Komisioni ka kryer një hetim sipërfaqësor, të cekët, të paragjykuar, duke arritur në konkluzion krejtësisht të gabuar. Është provuar se shumica e paguar për këtë pasuri është në vlerën 70.000 euro, shumë e paguar me transaksion bankar, nëpërmjet kredisë së disbursuar, çka nuk lë vend për diskutim të ligjshmërisë së burimit të kësaj shume. Në shkelje të hapur të procedurës, Komisioni nuk ka pritur përgjigjen nga shoqëria ndërtimore, por ka njoftuar rezultatet e hetimit vetëm tri ditë pasi i kishte kërkuar informacion shoqërisë ndërtimore, nën paragjykim të plotë dhe në konkluzion të gabuar. Mungesa e qëllimshme e administrimit të provës ka bërë të cenueshëm procesin e vendimmarrjes për këtë pasuri.
- b) Për pasurinë automjet i markës “Hyundai”, tip Tucson, në emër të bashkëshortit të subjektit, është e pashpjegueshme arsyeja e moshetimit nga ana e Komisionit, e dhënies së shumës 8.000 euro nga prindërit e bashkëshortit të subjektit, kur i ish-in vënë në dispozicion prova që tregonin mbi mundësitë e tyre financiare për dhënien e kësaj shume, përveç marrëdhënies së posaçme prindër-fëmijë, që as nuk është shkruar apo arsyetuar.
- c) Subjekti pretendon se arsyetimi i Komisionit që subjekti nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjen e likuiditeve në llogari bankare dhe ato cash) dhe kryerjen e shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si gjyqtare,

është i pabazuar në fakte dhe në ligj. Subjekti kundërshton rezultatet e analizës financiare të Komisionit për vitet 2007, 2010, 2011, 2014 e vijim, ku rezulton me balancë negative.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit lidhur me shkaqet procedurale të ankimit

5. *Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se nga ana e Komisionit vërehet një ngutje dhe një paragjykim i çështjes për të përfunduar në mënyrë të cekët dhe sipërfaqësore hetimin paraprak, procesin e rivlerësimit, pa vlerësuar të gjitha provat e grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak.*

Lidhur me këtë pretendim, nga analizimi i dokumentacionit të dosjes gjyqësore, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se procedurat e rivlerësimit për subjektin, znj. Enkeledi Hajro, kanë nisur më datë 13.06.2018 dhe hetimi administrativ është mbyllur më datë 22.05.2019, me vendimin nr. 2 të trupit gjykues të Komisionit. Gjatë fazës së hetimit administrativ të kryer, Komisioni nëpërmjet pyetjeve të dërguara subjektit, konkretisht më datë 19.07.2018 (pyetëtori standard), pyetjeve shtesë më datat 17.01.2019, 13.02.2019, 12.04.2019, rezultateve të hetimit më datë 23.05.2019, si dhe seancës dëgjimore në datën 05.06.2019, ka pasur për qëllim kryerjen e një hetimi të plotë e të thelluar administrativ dhe vetë shtrirja kohore prej gati një vit i procedurave të rivlerësimit, tregojnë se nuk ka pasur ngutje apo paragjykim për të përfunduar shqyrtimin e çështjes. Trupi gjykues çmon se koha e vënë në dispozicion nga Komisioni për të paraqitur prova e për të dhënë shpjegime gjatë hetimit administrativ, ka qenë e mjaftueshme për të sqaruar rrethanat dhe faktet lidhur me kriteret e rivlerësimit për subjektin. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

6. *Subjekti pretendon se argumentet dhe provat e kërkuara prej tij gjatë pyetësorëve në fazën hetimore, nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni dhe nuk janë vlerësuar siç duhet, pasi nëse do të ishte respektuar procedura, subjektit duhet t'i ishin njoftuar vendimmarrjet e ndërmjetme, në mënyrë që t'i jepej mundësia të paraqiste provat e nevojshme, bashkëlidhur ankimit, për të konfirmuar rrethanat e fakteve dhe argumentet e tij. Sa i përket këtij shkak ankimor, trupi gjykues konstaton se me anë të postës elektronike të datës 23.05.2019, subjekti njoftohet nga Komisioni për njohjen me rezultatet e hetimit administrativ, për kalimin e barrës së provës, për të drejtën për t'u njohur me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit etj. Në pikën 5 të këtij njoftimi, subjektit i njoftohet e drejta për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve apo marrjen e çdo prove mbështetëse dhe, për të ushtruar këtë të drejtë, Komisioni shprehet: *ju duhet të dërgoni një kërkesë, e cila duhet të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme, për identifikimin dhe kontaktimin e dëshmitarit ose të provës, si dhe të dhëna mbi thelbin e informacionit të pritshëm.**

Nga analizimi i akteve të dosjes, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur me përgjigjet e rezultateve të hetimit ndonjë kërkesë për thirrje dëshmitari apo marrjen e ndonjë prove mbështetëse, si specifikuar nga Komisioni, vetëm në një rast në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se: *nqs mund të jetë i nevojshëm konfirmimi i fakteve të parashtruara sa më sipër, mund të paraqes si dëshmitare vjehrrën time, L. H. (mqs vjehri im është ndarë nga jeta para disa muajsh).* Për sa më sipër, duke mos pasur një kërkesë me shkrim nga subjekti i rivlerësimit sipas njoftimit të Komisionit, ky i fundit nuk ka qenë në kushtet e refuzimit apo pranimit të kërkesës, që më pas të arsyetonte me vendim si parashikuar në nenin 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016, apo përcaktuar në pikën 8 të "Hapave proceduralë" të Komisionit. Në kuptim të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, me kalimin e barrës së provës,

duhet të provojë në mënyrë shteruese të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit, pa pritur që ky i fundit të refuzojë një provë për të paraqitur më pas një provë tjetër. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

7. *Subjekti pretendon se Kolegji dhe Komisioni kanë detyrimin kushtetues, të parashikuar në nenin Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, për të intervistuar të gjithë personat e përmendur në deklaratën e pasurisë “vetting”, por dhe persona të tjerë, si: L. H. (vjehera) dhe D. H. (kunata), që do të sillnin një kontribut të domosdoshëm për sqarimin e fakteve dhe vërtetësinë e deklaramit. GjEDNj-ja ka gjetur shkelje në rastin Stojakovic kundër Austrisë, nr. 30003/02, 9 nëntor 2006 dhe Gulmez kundër Turqisë, nr. 16330/02, 20 maj 2008, nëse nuk dëgjohen dëshmitarët e kërkuar nga ana e mbrojtjes.*

Sa i përket këtij pretendimi, trupit gjykues, nga analizimi i deklaratës për rivlerësimin e pasurisë vetting, nuk i rezulton që subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur, bashkëshorti, të kenë deklaruar personat e kërkuar të thirren si dëshmitarë në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit apo çdo cilësi tjetër si palë në një marrëdhënie civile, të ardhurat e përfituara prej të cilëve të jenë deklaruar si burim për krijimin e pasurive objekt shqyrtimi. Por, edhe nëse personat që kërkohen të thirren si dëshmitarë, do të ishin deklaruar si të tillë në deklaratën e pasurisë vetting, përsëri në kuptim të nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, Komisioni dhe Kolegji nuk kanë detyrimin t'i intervistojnë në çdo rast, por vetëm kur çmohet se provat me dëshmitarë mund të kontribuojnë në qartësimin e fakteve dhe rrethanave të çështjeve objekt shqyrtimi, të paqarta nga dokumentacioni provues ligjor. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

8. *Komisioni nuk ka dhënë asnjë arsye përse mbi të njëjtat prova ka arritur në një konkluzion të kundërt me ILDKPKI-në, si organ kompetent lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave. Komisioni ka shkelur nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, sepse nuk ka arsyetuar këtë “përmbysje” të vlerësimit të provave të paraqitura në deklaratën për rivlerësimin kalimtar lidhur me pasurinë.*

Sa i përket këtij shkak ankimor, me konsideratë dispozitat kushtetuese dhe ligjore që përcaktojnë kompetencat e organeve të rivlerësimit, parë në raport me vlerësimet e kryera nga organet e tjera të përfshira në këtë proces, si dhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, datë 18.01.2017, sipas të cilit organet e tjera të përfshira në procesin e rivlerësimit kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale për të ndihmuar institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre, arrihet në përfundimin se institucionet e rivlerësimit nuk janë të detyruara të ndjekin apo të kenë qëndrime e konkluzione të njëjta me ILDKPKI-në. Institucionet e rivlerësimit janë të autorizuara nga Kushtetuta dhe ligji të bëjnë hetimet e tyre, për të kryer një proces rivlerësimi të pavarur e të pandikuar nga konkluzionet e institucioneve ndihmëse. Ky qëndrim është mbajtur edhe në vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se ky shkak ankimi është i pabazuar dhe Komisioni nuk ka shkelur nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile¹, pasi vendimi i tij është mbështetur në aktet shpresore të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, të kryer në mënyrë të pavarur në kuadër të procesit të rivlerësimit.

9. *Sa u përket shkeljeve procedurale gjatë seancës dëgjimore, subjekti pretendon se procesi i rivlerësimit e përjashton apo e kufizon subjektin nga një sërë të drejtash në zbatim të disa*

¹ Neni 253 i Kodit të Procedurës Civile: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaramëve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”.

dispozitave të rëndësishme të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Kodit të Procedurave Administrative (neni 82) apo Kodit të Procedurës Civile, siç janë parimi i kontradiktoritetit dhe garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin.

Nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore, trupit gjykues në Kolegj i rezulton që subjekti i rivlerësimit të jetë shprehur se: *e gjithë procedura e ndjekur deri më tani nga Komisioni ka qenë korrekte. Ju falënderoj për këtë. Më është dhënë afati i duhur për t’u njohur me provat, për të paraqitur observacionet e mia. Absolutisht edhe pyetja që ju keni parashtruar, janë ato çka edhe neve sikurse dihet, deklaratat e pasurisë janë konsoliduar pas vitit 2010 e mbrapa. Për disa vite, bashkëshorti përkatës nuk ka qenë fare deklarues. Po ashtu, kemi kuptuar që kemi deklaruar për çka e kemi vetë, apo në bashkëpronësi dhe nuk kemi deklaruar për ato çfarë kanë bashkëshortët. Prandaj unë u mbetem atyre çfarë kam thënë. Konfirmoj të gjitha ato gjetjet e Komisionit. Qëndroj atyre që unë kam thënë me shkrim, sa u takon, lidhur me deklaratën vetting të bashkëshortit tim, për sa është plotësuar dhe dua të vë në dukje që ato gjetje kanë të bëjnë para se unë të filloj në detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Tiranës. Sa më sipër, nuk rezulton që gjatë seancës dëgjimore subjekti të ketë ngritur ndonjë pretendim lidhur me cenimin e së drejtës së diskutimit të gjetjeve të Komisionit, në kuadër të parimit të kontradiktoritetit parashikuar në nenin 20 të Kodit të Procedurës Civile, apo garantimit të ndonjë të drejte tjetër në kuadër të një procesi të rregullt ligjor. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.*

10. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se seanca dëgjimore është formale, ku relatori lexon rezultatet e hetimit sikurse i janë komunikuar subjektit, pa u shprehur për shpjegimet, argumentet, kërkesat, komentet e subjektit, së bashku me provat e dërguara përpara seancës gjyqësore, duke përdorur shprehje të gatshme të përgjithshme se “komentet e subjektit do të merren në konsideratë/vlerësim para dhënies së vendimit”. Kjo mënyrë pengon dhe cenon në masë jo proporcionale të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t’u mbrojtur. Në rastin konkret, vetë relatori, kur lexoi në mënyrë të përmbledhur raportin përfundimtar me rezultatet e hetimit, në mënyrë pohuese i krijoi subjektit pritshmërinë se shpjegimet e provat e paraqitura ishin pranuar me vlerë provuese para dhënies së vendimit.*

Sa i përket këtij pretendimi të lidhur me shkakun e ankimit të trajtuar në pikën pararendëse, nga procesverbali i seancës dëgjimore në Komision, rezulton që relatori i çështjes të ketë parashtruar përfundimet e arritura nga hetimi administrativ, përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit për pyetësorët e dërguar nga Komisioni, si dhe shpjegimet për rezultatet e hetimit. Kryesuesi i trupës gjykuese i ka dhënë fjalën znj. Enkeledi Hajro për të paraqitur qëndrimin e saj, si dhe për të dhënë shpjegime në lidhje me atë çka relatoi z. Relator, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit shprehet: *Falënderoj relatorin. Ishte korrekt në parashtrimin e të gjitha fakteve dhe të provave që unë kam paraqitur dhe u qëndroj observacioneve që unë kam paraqitur në komentet e mia lidhur me kthim-përgjigjen mbi rezultatet e hetimit të datës 27.05.2019. Nuk kam prova të tjera shtesë për të paraqitur, kështu që konfirmoj çfarë unë kam paraqitur me shkrim para jush. Trupi gjykues çmon se seanca dëgjimore do të ishte në kushtet e formalitetit nëse subjekti i rivlerësimit nuk do të kishte mundësinë të paraqiste pretendimet mbi parashtrimet e bëra nga relatori, ndërkohë që nga sa më sipër, rezulton e kundërta, subjekti është ftuar për të paraqitur qëndrimet e veta dhe nuk e ka bërë, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pabazuar.*

11. *Subjekti pretendon se procesi i rivlerësimit duhet të jetë një gjyq me palë kundërshtare dhe*

subjekti të jetë në pozitë procedurale, si çdo palë që paraqet kërkesat, shpjegimet, provat e saj, kundërshtimet, prapësimet, akte ekspertimi, përpara një gjykate të paanshme që ka juridiksion të plotë.

Për këtë pretendim, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit për subjektin, znj. Enkeledi Hajro, është zhvilluar sipas procedurave të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, duke garantuar zhvillimin e procesit të rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, si parashikuar në nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

12. *Mosmarrja në konsideratë e shkresës nr. {***} prot., datë 03.06.2019, "Informacion", përcjellë nga shtetasit A. K. dhe B. K., e cila nuk i është njoftuar subjektit të rivlerësimit, vjen në kundërshtim me pikën 9 të "Hapave proceduralë" të Komisionit, pasi përbën provë të re, depozituar brenda afateve ligjore. Mosnjohja me aktet e mbledhura në fazën e hetimit është gjetur si shkelje nga Gjykata Evropiane në rastin Aksoy (Eroglu) kundër Turqisë, nr. 59741/00, 31 tetor 2006, Guner Çorun kundër Turqisë, nr. 59739, 31 tetor 2006 dhe Kahraman kundër Turqisë, nr. 60366/00, datë 31 tetor 2006. Komisioni, në këtë mënyrë, ka fshehur provën që shkon në favor të subjektit të rivlerësimit. Pra, trupa gjykuese ka vepruar në kundërshtim me pikën "5" të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.*

Në analizë të këtij shkak ankimor, me referencë përcaktimet në pikën 9 të "Hapave proceduralë të unifikuar", vendosur nga Komisioni, se në rast se dosjes së një subjekti të rivlerësimit, i cili e ka ushtruar të drejtën e tij/saj për t'u njohur me dosjen, i shtohen prova apo fakte të reja, që ndikojnë në vendimmarrje, për të cilat subjekti nuk ka marrë dijeni, ky subjekt do të njoftohet përsëri për t'u njohur me to, sipas procedurës më sipër, trupi gjykues në Kolegj konstaton se Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.05.2019, u është drejtuar shtetasve B. dhe A. K. në cilësinë e palës shitëse, sipas kontratë shitje me rezervë (pasuri e paluajtshme) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.06.2007, për apartamentin me sipërfaqe 85 m², të ndodhur në rr. "{***}", Tiranë, duke kërkuar informacion brenda një afati 15-ditor, mbi vlerën e plotë të kontratës, mënyrën e shlyerjes së detyrimit kontraktor, kopje të mandatpagesave etj. Komisioni ka administruar përgjigjen e shtetasve K. më datë 03.06.2019, pasi subjekti i rivlerësimit kishte dërguar shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se Komisioni, përpara dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ, duhet të kishte administruar edhe informacionin e kërkuar nga shtetasit K.. Në rastin konkret, nisur nga përmbajtja e informacionit të përcjellë nga shtetasit B. dhe A. K., i cili do të analizohet më gjerësisht në analizimin e kriterit për vlerësimin e pasurisë në këtë vendim, trupi gjykues çmon se njohja e subjektit me këtë provë të re, nisur nga përmbajtja e saj, nuk do të sillte ndryshim në vendimmarrjen e Komisionit dhe nuk ndikon në vlefshmërinë e vendimit të tij, e për rrjedhojë pretendimin e subjektit se Komisioni ka fshehur këtë provë, trupi gjykues e gjen të pabazuar.

13. *Subjekti pretendon se asnjëri nga anëtarët e trupës gjykuese nuk ka pasur funksionin e gjyqtarit apo të magjistratit dhe nuk ka pasur përvoja të mëparshme në procedurat lidhur me ndjekjen disiplinore të gjyqtarëve apo prokurorëve. Në rastin (Baka kundër Hungarisë, 23.06.2016, paragrafi 121), GjEDNj-ja ka përcaktuar rëndësinë që ka zbatimi i një procesi të rregullt në procedurat lidhur me shkarkimin e gjyqtarëve.*

Trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit gjen përgjigje në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 67, ku thuhet shprehimisht se: për nga mënyra se si është

konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Sa më sipër, pretendimi i subjekti është i pabazuar.

14. *Gjykimi i çështjes, sipas subjektit në ankim, nuk është kryer me objektivitet, pasi e njëjta trupë që ka kryer hetimin paraprak, ka gjykuar themelin dhe bazueshmërinë e gjetjeve. GjEDNj-ja ka gjetur shkelje të nenit 6 të KEDNj-së për mosrespektim të parimit të drejtë e të rregullt ligjor në ato raste që ka pasur një përzierje të funksionit publik midis organit që kryen hetimin dhe atij që ka vendosur mbi themelin e çështjes. Koncepti i gjykatës është i pavarur nga shteti dhe përfshin edhe autoritete të tjera që janë të administratës publike (shih rastin Sramek kundër Austrisë, paragrafi 36). Lidhur me këtë shkak ankimor, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka vepruar në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore dhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar.*
15. *Sa i përket zbatimit të nenit 6 të KEDNj-së, subjekti pretendon se natyra e procedurës së rivlerësimit, pasojat dhe masat e parashikuara nga ligji i vetting-ut janë tejet të ashpra dhe të rënda, prandaj ato duhet të cilësohen si të natyrës penale, për rrjedhojë duhet të zbatohen edhe të drejtat e procesit penal. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se institucionet e rivlerësimit ushtrojnë veprimtarinë e tyre bazuar në Kushtetutë, ligjin nr. 84/2016, si dhe ligjet e tjera procedurale që parashikohen për t'u zbatuar në këtë proces, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor. Procesi i rivlerësimit nuk është një proces penal. Në nenin E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 58, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 janë përcaktuar masat disiplinore që zbatohen nga institucionet e rivlerësimit për subjektet që i nënshtrohen këtij procesi, në përfundim të të cilit Komisioni vendos sa vijojnë: a. konfirmim në detyrë; b. pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës; c. shkarkim nga detyra [...]. Janë pikërisht këto dispozita kushtetuese dhe ligjore të cilat kanë parashikuar llojin e masave disiplinore që jepen nga Komisioni në fund të procesit të rivlerësimit. Masat e tjera penalizuese apo parandaluese, siç pretendon subjekti në ankim, që rrjedhin pas marrjes së masës disiplinore nga institucionet e rivlerësimit, nuk janë në kompetencë të këtyre të fundit.*
16. *Subjekti pretendon se është tepër e rëndësishme që të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit të respektohen dhe të zhvillohet një gjykim i drejtë, sipas standardeve të miratuara. Është me rëndësi të evidentohet fakti se e drejta për një proces të rregullt ligjor nuk është përfshirë as formalisht në listën e të drejtave dhe garancive, të cilat kufizohen nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.*
Lidhur me këtë pretendim, neni A, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: 1. Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi "f", 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi "b", 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi "b", kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit nuk evidenton se në cilin nga nenet e parashikuara në këtë dispozitë të Aneksit të Kushtetutës është cenuar e drejta e saj. Nga analizimi i procedurave ligjore të ndjekura nga Komisioni, trupit gjykues i rezulton që procesi i

rivlerësimin të subjektit të rivlerësimin, znj. Enkeledi Hajro, të jetë zhvilluar pa cenuar të drejtën e saj për një proces të rregullt ligjor.

17. *Subjekti i rivlerësimin pretendon në ankim se nuk ndodhet në kushtet e zbatimit të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 që të legjitimohet shkarkimin nga detyra, pasi, në bazë të një interpretimi gramatikor dhe sistematik të kësaj norme, kërkohet në mënyrë kumulative pamjaftueshmëria e të dy kritereve, atij pasuror dhe të figurës, ndërkohë që për kontrollin e figurës subjekti ka arritur një nivel të besueshëm.*

Trupi gjykues vlerëson se nuk është e nevojshme që pamjaftueshmëritë në deklaram për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë të ekzistojnë në mënyrë kumulative për të konkluduar me vendimmarrjen për shkarkim nga detyra të subjektit të rivlerësimin, qëndrim i mbajtur nga Kolegji në jurisprudencën² e tij të deritanishme. Ky arsyetim përforcohet me sa parashikuar në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës konfirmimi në detyrë i subjektit kërkon plotësimin në mënyrë kumulative të tri kritereve të rivlerësimin, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe aftësive profesionale, në të kundërt, nëse subjekti nuk plotëson njërin prej tyre, ndaj tij merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

18. *Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë nenin D, pika 5, fjalia e dytë e Aneksit të Kushtetutës. Nëse nuk janë plotësuar dhe arsyetuar prania e elementeve të nevojshme që kërkon kjo dispozitë, kalimi i barrës së provës është antikushtetues. Komisioni nuk ka respektuar detyrimin kushtetues dhe ligjor të arsyetohet se përse provat e paraqitura nuk janë të pranueshme apo nuk janë të besueshme. Duke qenë se dispozitat kushtetuese bëjnë fjalë për përpjekje, për tentativë për pasaktësi ose tentativë për fshehje, është e rëndësishme që Komisioni të evidentonte anën objektive të shkakut të pretenduar si shkelje që ka për qëllim fshehjen apo pasaktësitë. Në rast se do të pranohet të kundërtën, çdo pasaktësi në deklaratën vetting do të sillte automatikisht shkarkimin nga detyra, ndërkohë që parashikimi kushtetues e ka lidhur praninë e pasaktësive me përpjekjet për të fshehur pasurinë, pra me një sjellje të subjektit që tregon pikërisht këtë qëllim.*

Në kuptim të nenit D, pika 5, fjalia e dytë e Aneksit të Kushtetutës, nëse subjekti i rivlerësimin përpjeket të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. Nga analizimi i deklaratës për rivlerësimin e pasurisë vetting, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimin nuk ka deklaruar në mënyrë të plotë burimin e krijimit të pasurive, konkretisht, për pasurinë automjet “Hyundai Tucson”, subjekti pretendon se nuk ka qenë në dijeni të faktit se duhej deklaruar dhe “burimi” i burimit për këtë automjet. Nga sa më sipër, rezulton që subjekti i rivlerësimin nuk ka deklaruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016.

Sa i takon pretendimit të subjektit se Komisioni nuk ka respektuar detyrimin kushtetues dhe ligjor të arsyetohet se përse provat e paraqitura nuk janë të pranueshme apo nuk janë të besueshme, nga analizimi i vendimit nr. 154, datë 10.06.2019, të Komisionit, trupit gjykues në Kolegji i rezulton që edhe pse nuk janë cituar në mënyrë specifike provat e depozituara nga subjekti me përgjigjet e pyetësorëve apo rezultatet e hetimit administrativ, nga arsyetimi i Komisionit del qartë konkluzioni i tij për pranimin ose jo të këtyre provave.

² Shih vendimet nr. 8, datë 16.04.2019, paragrafi 79; nr. 10, datë 19.11.2018, paragrafi 65 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nuk ka ardhur vetëm për shkak të pasaktësive në deklaram, por edhe për shkak të pamjaftueshmërisë në deklaram, nga ku ka rezultuar mungesë e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera për periudhën e rivlerësimit. Në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, objekti i hetimit dhe i rivlerësimit konsiston pikërisht në saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve të subjektit, ku në çdo rast subjekti ka detyrimin të deklarojë tërësinë e pasurisë dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive dhe të të ardhurave, sipas përcaktimeve kushtetuese dhe ligjore.

19. *Subjekti, lidhur me njohjen e materialeve të dosjes përpara zhvillimit të seancës dëgjimore, pretendon se Komisioni nuk i ka dhënë mundësinë të njihet me mendimet apo procesverbalet dhe vendimet e ndërmjetme mbi provat, duke theksuar trajtimin e pabarabartë dhe të paarsyeshëm të subjektit të rivlerësimit në raportin me relatorin, trupin gjykues dhe në raport me vëzhguesin ndërkombëtar. Mospërfshirja për njoftim të të gjithë materialit të dosjes në të cilën mbështetet vendimi i dhënë kundër palës së interesuar, referuar akteve, si mendimet apo procesverbalet dhe vendimet e ndërmjetme, përbën një mungesë të rëndë në proces për parashikimin e nenit 6, pika 1 e KEDNj-së (rasti Edwards k. Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 36).*

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se më datë 24.07.2019, subjekti ka kërkuar pranë Komisionit kopje të procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 05.06.2019 në CD, për seancën e zhvilluar në audio dhe të transkriptuar, kopje të shkresës nr. {***} prot., datë 20.05.2019, drejtuar shtetasve B. dhe A. K. dhe përgjigjen e ardhur; kopje të procesverbaleve të mbajtura për diskutimet dhe vendimet e ndërmjetme të marra nga trupi gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar para seancës dëgjimore.

Me shkresën nr. {***} prot., datë 25.07.2019, Komisioni vendos në dispozicion të subjektit dy kërkesat e para, kopjen e procesverbalit të seancave dëgjimore të datës 05.06.2019, si dhe të datës 10.06.2019, një CD për seancat e zhvilluara në audio dhe të transkriptuara; kopje të shkresës nr. {***} prot., datë 20.05.2019, të Komisionit drejtuar shtetasve B. dhe A. K., si dhe përgjigjen e ardhur pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 03.06.2019. Sa i takon kërkesës së tretë për kopjen e procesverbaleve të mbajtura për diskutimet dhe vendimet e ndërmjetme të marra nga trupi gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar para seancës dëgjimore, Komisioni informon subjektin se *këto akte nuk mund të vihen në dispozicion pasi janë akte të brendshme të trupit gjykues, të cilat nuk shërbejnë dhe nuk kanë shërbyer në vendimmarrjen e tij.*

Gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, trupi gjykues konstaton se procesverbalet i paraprijnë vendimit, konkretisht vendimit nr. 1, datë 21.03.2018, me anë të të cilit është vendosur kryesuesi i trupës gjyqësore, është deklaruar faktit se asnjëri nga anëtarët e trupës nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin, si dhe është vendosur fillimi i hetimit administrativ; vendimit nr. 2, datë 22.05.2019, për mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, kalimin e barrës së provës subjektit e njoftimin për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, dhe të drejtën e subjektit për të kërkuar thirrjen e dëshmitarit apo marrjen e provave të tjera; vendimit nr. 3, datë 03.06.2019, për kalimin në seancë dëgjimore të subjektit të rivlerësimit. Ashtu si sqaruar më sipër, nuk rezulton që gjatë procesit të rivlerësimit Komisioni të ketë marrë vendime të ndërmjetme, që më pas t'i vinte në dispozicion të subjektit të rivlerësimit. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

20. *Subjekti pretendon se është diskriminuar për shkak të përkatësisë në një grup të caktuar, sikurse ish-e përndjekur politike, si dhe për shkak të eksperiencës profesionale para emërimit si*

gjujtare në korrik 2014, duke e radhitur në një orientim politik të caktuar. Subjekti pretendon se ndaj saj është zhvilluar një sulm mediatik për të denigruar dinjitetin dhe reputacionin profesional, që subjekti pretendon se ka ndikuar në mbarëvajtjen e procesit të vetting-ut.

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar përgjatë procesit të rivlerësimit në Komision, nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që Komisioni të mund të ketë mbajtur qëndrime apo të ketë arritur në konkluzione diskriminuese për shkaqe, si: *gjinia, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose çdo status tjetër.* Pretendimi i subjektit se Komisioni ka zhvilluar një sulm mediatik për të denigruar dinjitetin dhe reputacionin profesional që ka ndikuar në mbarëvajtjen e procesit të rivlerësimit, mbetet i paargumentuar, pasi ai nuk ka shpjeguar se mbi ç'bazë e ngre këtë pretendim.

21. Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur ankimit, ka paraqitur aktet shkresore të mëposhtme, të cilat kërkon të merren në cilësinë e provës nga Kolegji dhe riçeljen e hetimit gjyqësor.

1. Informacioni i protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 03.06.2019, kontratë shitje me rezervë (pasuri e paluajtshme) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.06.2007, vërtetim nga dokumentet hipotekor nr. {***}, datë 11.06.2007, *statement* bankar Alpha Bank, kthim përgjigjeje kërkesës suaj për dokumentacion nr. {***}, datë 20.05.2019.
2. Shkresa “Kthim përgjigjeje kërkesës suaj” nr. {***} prot., datë 25.07.2019, e Komisionit.
3. Dëgjimin e shtetasës L. H., me të cilën ka marrëdhënie të posaçme.
4. Dëgjimin e shtetasës D. H..
5. Dëgjimin e shtetasit A. H..
6. Deklarata noteriale të shtetasve L. dhe S. H. nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.01.2019.
7. Deklarata noteriale e znj. D. H. nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.01.2019.
8. *Statement* bankar që provon gjendjen e likuiditeteve të shtetasve S. H., L. H., në lekë dhe në euro.
9. Raport Teknik nga ekspertja R. Q., datë 29.07.2019, dhe përshkrimi i pronës, njësi shërbimi, Shkodër.
10. Këqyrja në vend e objektit, njësi shërbimi, Shkodër.
11. Akt vlerësimi i pronës 2+1, Tiranë, bërë më datë 22.06.2007, nga ekspertja vlerësuese S. B. (për llogari të Alpha Bank).
12. Akt vlerësimi i pronës 1+1, Shkodër, bërë më datë 19.11.2007, nga ekspertja vlerësuese E. I. (për llogari të Alpha Bank).
13. Akt vlerësimi, përgatitur nga ekspertja vlerësuese G. M., më datë 08.08.2012 (për llogari të Bankës Kombëtare Tregtare).
14. Akt vlerësimi i pronës 1+1 në Shkodër, bërë me datë 22.08.2012, nga ekspertja vlerësuese E. I. (për llogari të Bankës Kombëtare Tregtare).
15. Raporti i ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 02.02.2018, për subjektin Enkeledi Hajro.
16. Autorizim përdorimi, lëshuar nga Tirana Leasing Sh.A., 10.01.2010.
17. Polica për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike, bërë më datë 05.01.2012, nr. {***}.
18. Kontrata e sigurimit të mjetit motorik “Scoda Fabia”, datë 10.02.2012, nr. {***}.
19. Vërtetim page D. H., i bankës Credins, për periudhën 01.03.2007 – 01.07.2010.
20. Vërtetim page nr. {***}, datë 05.08.2019, i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, për periudhën 01.07.2010 – 04.11.2013, për D. H..

21. Kontratë e qirasë financiare (*leasing*), në shumën prej 20.000 euro, nr. {***}, datë 18.08.2010, për automjetin “Hyundai Tucson”.
 22. Kredi nga Credins Bank në vlerën 4.000 euro, nga D. H..
 23. Deklaratë e znj. M. G., ish-ambasadore, përfaqësuese e përhershme e Shqipërisë në Strasburg, Francë, maj 2007 – shtator 2013.
 24. Vërtetim i Dhomës Kombëtare të Noterisë nr. {***}, datë 01.08.2019.
 25. Deklaratë noteriale e z. G. Sh. nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.09.2019.
 26. Kthim përgjigjeje, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, nr. {***}, datë 18.10.2011.
 27. Procesverbal konstatimi për objektin dyqan nr. {***}, datë 13.11.2006, njësia tregtare në Shkodër.
 28. Deklaratë noteriale A. K., B. K. nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.07.2019.
 29. Deklaratë L. M., datë 18.02.2019, për dhënie me qira z. S. H., një ambient për ushtrimin e profesionit mjek stomatolog, si dhe praktika e regjistrimit.
 30. Praktika e privatizimit të pasurisë, njësi shërbimi, të truallit.
22. Nga analizimi i akteve të administruara në fashikullin gjyqësor, trupit gjykues i rezulton që disa nga aktet të cilat subjekti i rivlerësimit kërkon të merren në cilësinë e provës, rezultojnë të jenë administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, pjesë e këtij fashikulli gjyqësor, pra nuk përbëjnë provë të re. Për më tepër, për një pjesë të akteve, në ankimin e tij, subjekti nuk ka provuar se ishte në pamundësinë e paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ në Komision, sipas parashikimit të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012³, i ndryshuar. Por, edhe nëse prezumohet në favor të subjektit se këto akte do të plotësonin kriteret ligjore, përsëri në kuptim të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson që marrja e këtyre akteve në cilësinë e provës është e panevojshme dhe nuk ndikon në vendimmarrjen e Kolegjit.
 23. Në përfundim të vlerësimit të shkaqeve me natyrë procedurale dhe në analizë të parashikimeve ligjore të cituara më sipër, trupi gjykues vlerëson se nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.
 24. Për sa arsyetuar më sipër, çështja e rivlerësimit me nr. 45 regjistër (JR), datë 23.09.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, u mor në shqyrtim në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e pasurisë dhe shkaqet e ankimit

25. Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar

³ Neni 47 i ligjit nr. 49/2012: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

(në vijim “ligji nr. 9049”) dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë.

26. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishëm të pasurisë së subjektit, me shkresën nr. {***} prot., datë 02.02.2018, ka dërguar pranë Komisionit aktin e kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit, znj. Enkeledi Hajro, duke arritur në konkluzionin se:

i. ka pasaktësi në deklaram;

ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;

iv. nuk ka kryer deklaram të rremë;

v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

27. Nisur nga aktet shkresore që janë administruar në dosjen gjyqësore, si dhe shkaqet në ankim të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit kryen kontrollin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, duke u dhënë përgjigje shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me kriteret që parashikojnë dispozitat e mësipërme.

28. Për pasurinë *njësi tregtare me sipërfaqe 22 m²*, ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër, të përfiturar me kontratë shitjeje, më 28.01.1992, nga Agjencia e Privatizimit, dega Shkodër, në atë periudhë subjekti nuk kishte mbushur moshën 18 vjeç për të fituar zotësinë juridike për të vepruar, e për të nënshkruar këtë kontratë, por duke pasur parasysh faktin se kjo pasuri është përfiturar për shkak të statusit si ish-e përndjekur politike, kohën e gjatë nga përfitimi i pasurisë (viti 1992), vlerën e vogël monetare të këtij transaksioni, 4.396 lekë, shpjegimet e dhëna nga subjekti, si dhe faktin që kjo pasuri nuk ka pësuar ndryshime/ndërtim shtesë, sipas konfirmimit të ALUIZNI-t Shkodër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri janë të drejta dhe çmon se nuk ndodhemi në kushtet e aplikimit të nenit 33, pika 5, geramat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016.

Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 85 m², ndodhur në rr. “”, Tiranë***

29. Komisioni për këtë pasuri ka arritur në konkluzionet se *subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, si bazuar në deklaratat periodike vjetore, si në deklaratën “vetting”; ka mospërputhje deklarimesh dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme; Komisioni, bazuar në pikat 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, konstatoi se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi të saj.*

30. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007, si vijon: *apartamenti i banimit 1+1, me sipërfaqe 46 m², i ndodhur në lgj. “{***}”, në Shkodër, është vënë si garanci në hipotekë për shlyerjen e kredisë për blerjen e apartamentit në*

Tiranë, rr. “{***}”, në deklaratën e të njëjtit vit, personi i lidhur, bashkëshorti, deklaroi si vijon: *blerje apartament banimi me sipërfaqe 85 m² (2+1) në rr. “{***}”, kompleksi K., shk. {***}, kati i {***}’ë, me kontratë shitje me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 21.06.2007 [...], në vlerën 82.000 euro. Pjesa takuese ½ me bashkëshortin.*

Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2009, subjekti deklaroi: *apartament banimi 85 m², rr. “{***}”, hyrja {***}, Ap. {***}. Vlera 70.000 euro. Pjesa takuese 50%.*

Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës të vitit 2014, të dorëzuar më 08.08.2014, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *blerje me kredi tregtare pranë Alpha Bank, në vitin 2007, e një apartamenti banimi me sip. 85 m² në rr. “{***}” Tiranë. Nd {***}, Ap {***}, në vlerën 70.000 Euro. Kjo kredi është blerë nga BKT në 2012 për vlerën 8.600.000 lekë, me afat 20 vjet, interesi 4% (kredi shtetërore) dhe 7,99% i ndryshueshëm (kredi tregtare), me këste mujore sipas kontratave dhe listëpagesës bashkëlidhur, në pronësi të përbashkët me bashkëshortin, me nga ½ pjesë takuese. Në vlerën 70.000 Euro, 8.600.000 Lekë. Po të njëjtin deklaram, subjekti ka bërë dhe në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2014.*

Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti deklaroi: *blerje me kredi tregtare pranë Alpha Bank në 2007 e një apartamenti banimi me sip. 85 m², në rr. “{***}” Tiranë [...] në vlerën 70.000 euro. Kjo kredi është blerë nga BKT në 2012.*

Në deklaratën e pasurisë vetting 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Apartment banimi në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe funksionale 85 m², e ndodhur në rr. “{***}”, Nd {***}, {***}, Ap {***}, Tiranë, blerë me kredi të marrë nga “Alpha Bank”, 70.000 euro, sipas marrëveshjes në kontratën e shitjes me rezervë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2007, për vlerën 82.000 euro, pasi banka mbulonte vetëm 70% të vlerës së blerjes së apartamentit dhe Kontratës së Kredisë për blerje apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.07.2007. Kjo kredi është blerë nga BKT në shtator 2012, në vlerën 8.600.000 lekë, e cila përbëhet nga dy kredi: njëra shtetërore, 5.000.000 lekë, me interes fikse 4% dhe tjetra kredi tregtare në vlerën 3.600.000 lekë, me interes të ndryshueshëm. Në vlerën 82.000 euro.*

31. Pasuria objekt shqyrtimi rezultoi të jetë përfutur me anë të kontratës shitje me rezervë (pasurie të paluajtshme) me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2007, nënshkruar me shitësve B. K., A. K. dhe V. K. dhe blerësve Enkeledi Hajro dhe A. H.. Në këtë kontratë, çmimi i apartamentit i ndodhur në rrugën “{***}”, zona kadastrale {***}, pasuria nr. {***}, është përcaktuar në vlerën 82.000 euro. Sipas përcaktimeve në kontratë, shitja e apartamentit bëhet me rezervë, që konsiston në faktin se çmimi i shitjes prej 82.000 eurosh do të paguhet në dy këste, konkretisht: më dt. 21.06.2007 blerësit Enkeledi Hajro dhe A. H. paguan këstin e parë të shitjes në masën 7.000 euro [...] Diferencën e çmimit prej 75.000 eurosh [...] blerësit do ta likuidojnë në favor të shitësve nëpërmjet një kredie bankare që ata do të marrin pranë Alpha Bank Tiranë. Pagesa e dytë do të bëhet deri më 30 korrik 2007.
32. Duke iu referuar të dhënave të kartelës së pasurisë së paluajtshme (seksioni i pronësisë), përcjellë nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.07.2018, kjo pasuri rezultoi e regjistruar në emër të A. H. dhe Enkeledi Hajro më datë 31.07.2007 dhe certifikata për vërtetimin e pronësisë në emër të tyre është lëshuar më datë 25.07.2012.

33. Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore, deklaratës së pasurisë *vetting* dhe dokumentacionit justifikues ligjor të sipërcituar, trupi gjykues konstaton mospërputhje sa i përket deklaratimit të çmimit të blerjes së apartamentit, konkretisht në deklaratën periodike të vitit 2007 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, vlera e apartamentit është deklaruar 82.000 euro, ndërsa në deklaratat periodike të viteve 2009, 2014 dhe 2015 vlera e apartamentit deklarohet 70.000 euro përkatësisht.
34. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit deklaron në deklaratën e pasurisë *vetting* vetëm kredinë e marrë nga Alpha Bank ShA, në shumën 70.000 euro, të blerë më pas nga BKT-ja në shtator 2012, në vlerën 8.600.000 lekë. Për sa më sipër, trupi gjykues analizoi aktet në dosjen gjyqësore, nga ku konstatoi se më datë 31.07.2007, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar me Alpha Bank ShA kontratën për *kufi kredie shumëqëllimore nr. {***}, datë 31.07.2007* (nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.07.2007). Sipas kësaj kontrate, banka u ka çelur kredimarrësve A. H. dhe Enkeledi Hajro *kufirin e kredisë* në shumën 60.000 euro, me afat të pacaktuar, i cili mund të shtohet apo pakësohet në përputhje me nevojat e kredimarrësve. Alpha Bank ShA, nëpërmjet dokumentit “Deklaratë” nr. {***}, datë 12.09.2012, të lëshuar me kërkesë të subjektit dhe bashkëshortit të saj, konfirmon se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro dhe bashkëshorti i saj janë financuar me kredi për *blerje apartamenti në shumën 55.000 euro dhe kredi për rikonstrukcion apartamenti në shumën 15.000 euro*. Ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të dyja kreditë më sipër si burim krijimi të pasurisë objekt shqyrtimi. Referuar *lëvizjeve të llogarisë* në Alpha Bank ShA të subjektit dhe të personit të lidhur, rezulton se më datë 03.08.2007 është disbursuar kredia në vlerën 55.000 euro, e cila në të njëjtën datë është transferuar nga llogaria bankare e Enkeledi dhe A. H. në favor të A. K. dhe A. K., ndërsa kredia në shumën 15.000 euro është disbursuar më datë 25.01.2008 dhe, më datë 12.03.2008, është transferuar në llogari të A. K. dhe A. K. *për blerje apartamenti*. Në shtator 2012, kredia e akorduar nga Alpha Bank ShA rrefinancohet nga BKT ShA dhe, më datë 10.09.2012, nënshkruhen dy kontrata kredie bankare mes BKT ShA në cilësinë e kredidhënësit, dhe Enkeledi Hajro (B.) në cilësinë e kredimarrësit, si dhe A. H. dhe M. Sh. si dorëzanës: i) *kontratë kredi bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.09.2012, për shumën 5.000.000 lekë, me normë interesi 4%, me afat 324 muaj*; ii) *kontratë kredi bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.09.2012, për shumën 3.600.000 lekë me interes të ndryshueshëm në fund të çdo fund viti kalendarik, për një afat 240 muaj*. Nga lëvizjet e llogarisë së kredisë përcjellë nga Alpha Bank ShA me shkresën nr. {***} prot., datë 14.01.2019, rezulton se më datë 26.09.2012 janë transferuar nga BKT ShA në Alpha Bank ShA fondet në shumën 8.470.000 lekë për rrefinancimin/blerjen e dy limiteve të kredisë financuar subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur më 03.08.2007 dhe 25.01.2008, në shumat 55.000 euro dhe 15.000 euro, përkatësisht. Kredia e lehtësuar në shumën 5.000.000 lekë është përfituar në bazë të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar, të vendimit nr. 600, datë 12.09.2007, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, si dhe udhëzimet përkatëse mbi masën e subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti. Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 05.07.2018, të ZVRPP, Tiranë, kjo pasuri, më datë 31.07.2007, rezultonte e bllokuar në favor të Alpha Bank dhe, më datë 13.09.2012, bllokohet në favor të Bankës Kombëtare Tregtare për shlyerjen e shumës 8.600.000 lekë.

35. *Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon që shuma prej 12.000 eurosh është përfshirë padrejtësisht në analizën financiare të Komisionit, duke rënduar bindshëm balancën negative në kundërshtim me provat dhe deklaratimet. Në vlerësimin e Kolegjit, nisur nga fakti që i) në aktin e vetëm ligjor të fitimit të kësaj pasurie, konkretisht, kontratë shitje me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2007, është përcaktuar që çmimi i blerjes së apartamentit është në vlerën 82.000 euro; ii) kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP nëpërmjet kësaj kontrate më datë 31.07.2007; iii) nuk rezulton të jetë depozituar dokumentacion ligjor për ndryshimin e kontratës dhe çmimit të përcaktuar në të, trupi gjykues gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit, i cili ka marrë në konsideratë çmimin e apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, në vlerën 82.000 euro, sipas kontratës së sipërcituar dhe deklaratimit në deklaratën së pasurisë *vetting*.*
36. *Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kontrata është një veprim juridik vullnetar midis palëve dhe mund të kryhet me shkrim ose me gojë, si dhe me çfarëdolloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit midis palëve dhe se palët me vullnetin e tyre kanë liri të plotë në zgjedhjen jo vetëm të përmbajtjes së veprimit, por edhe të formës së veprimit juridik, trupi gjykues e gjen të pabazuar, pasi veprimet juridike lidhur me kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme duhet të bëhen me shkrim (*ab substantiam*), në të kundërt nuk janë të vlefshme dhe nuk prodhojnë pasoja juridike.*
 Në zbatim të nenit 193, germa “b” e Kodit Civil, kontratat me të cilat krijohen, njihen, ndryshohen të drejtat e pronësisë mbi sendet e paluajtshme duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Sa më sipër, kontrata e shitjes me rezervë nuk mund të ndryshohet verbalisht, por vetëm me ndryshim kontrate që po ashtu regjistrohet. Nga analizimi i të dhënave në kartelën e pasurisë së kësaj prone në ZVRPP, rezulton se kjo pasuri është regjistruar në emër të Enkeledi Hajro dhe A. H. më datë 31.07.2007, nëpërmjet *kontratës së shitjes 2007*. Për sa më sipër, kjo kontratë, me të gjitha parashikimet e saj, vazhdon të mbetet në fuqi deri në shfuqizimin apo ndryshimin e saj.
37. *Në mbështetje të arsytimit më sipër, trupi gjykues, nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar si burim krijimi vetëm kredinë e financuar në vlerën 70.000 euro dhe jo burimin e krijimit për gjithë çmimin e apartamentit në vlerën 82.000 euro, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “*vetting*”, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në vlerën 82.000 euro, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.*
38. *Me konsideratë çmimin dhe mënyrën e pagesës të përcaktuar në kontratën e shitjes me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2007, blerësit Enkeledi Hajro dhe A. H. paguan këstin e parë të shitjes në masën 7.000 euro [...] Diferencën e çmimit prej 75.000 eurosh [...] blerësit do ta likuidojnë në favor të shitësve nëpërmjet një kredie bankare që ata do të marrin pranë Alpha Bank Tiranë. Pagesa e dytë do të bëhet deri më 30 korrik 2007, referuar dokumentacionit justifikues të administruar në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se pagesa në shumën 55.000 euro nga kredia e disbursuar nga Alpha Bank ShA është bërë më datë 03.08.2007 dhe jo sipas përcaktimeve të kontratës më datë 30.07.2007. Ndryshe nga Komisioni në vendim, i cili përllëgarit si të likuiduar tërësisht shumën 82.000 euro në analizën financiare të kryer për vitin 2007, me kredi në shumën 70.000 euro, në Kolegj u përllëgarit mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe e personit të lidhur me të për të justifikuar pagesën e shumës 7.000 euro, e paguar më datë 21.06.2007, ditën e nënshkrimit të kontratës, si dhe e shumës 5.000 euro, e paguar më datë 03.08.2007 (me konsideratë faktin që 55.000 euro u likuiduan nga kredia e*

financuar nga Alpha Bank ShA në këtë datë, 03.08.2007).

39. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj deri në likuidimin e kështit të parë, bazuar në dokumentacionin justifikues dhe vlerësimin ligjor në Kolegj, rezultoi që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën -182.248 lekë për të kryer pagesën në shumën 7.000 euro, më datë 21.06.2007 dhe për të justifikuar shpenzimet e kryera deri më këtë datë. Nga analiza e kryer deri në datën e likuidimit të dy kësteve (7.000 euro më datë 21.07.2007 dhe 5.000 euro më 03.08.2007), ka rezultuar mungesë e burimeve financiare të ligjshme në vlerën -710.999 lekë për likuidimin e shumës 12.000 euro më datë 03.08.2007, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
40. I pyetur nga Komisioni për burimin e ligjshëm të shumës 5.000 euro, si diferencë mes kështit të dytë në vlerën 75.000 euro të parashikuar në kontratën e shitjes me rezervë dhe kredisë së financuar nga Alpha Bank ShA në vlerën 70.000 euro, si dhe për dokumentacionin provues për kalimin e shumës prej 12.000 eurosh, të cilat janë dhënë *cash*, subjekti i rivlerësimit në përgjigjen e pyetjes nr. 2 të Komisionit, më datë 16.04.2019, shpjegon se: *vlera reale e blerjes së apartamentit ka qenë 70.000 euro, por me palën blerëse arritëm në marrëveshje që në kontratë të shkruhej vlera 82.000 euro, me qëllim që banka të më debitonte vlerën që i korrespondonte vlerës së blerjes sipas ofertës me 70%. Prandaj sikurse ju kam dërguar në përgjigjen time të datës 25 shkurt 2019 [...], deklarata e datës 12.09.2012, e lëshuar nga Alpha Bank, provon pikërisht këtë fakt: që më janë debituar 70.000 euro për blerje apartamenti por të ndarë në dy këste: blerje dhe rikonstruksion, sepse kësti i parë 55.000 euro janë 70% e 82.000 eurove (vlera e blerjes) sikurse ishte edhe oferta e bankës dhe rikonstruksion 15.000 euro që në fakt i është shtuar shumës totale të kredisë për blerjen e apartamentit prej 70.000 euro. [...] Duhet të sqarohet që ne kemi blerë një apartament të ri, të përfunduar, që nuk kishte nevojë për asnjë rikonstruksion.*
Për sa më lart, deklaroj se unë nuk kam pasur asnjëherë 12.000 euro cash dhe palës shitëse A. K. i kam paguar vetëm vlerën e apartamentit 70.000 euro, që është transferuar me bankë [...].
41. Të njëjtin qëndrim mban subjekti i rivlerësimit edhe në përgjigje të rezultateve të hetimit, pas kalimit të barrës së provës në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, se *vlera reale e blerjes së apartamentit është 70.000 euro, sikurse e kam deklaruar edhe në deklaratat periodike që kam bërë ndër vite, ndërsa deklarimi në përmbajtje të deklaratës së vetting-ut tregon vlerën e pasqyruar në kontratë, duke i qëndruar strikt referimit në kontratë për vlerën prej 82.000 eurosh. Ndoshta do të duhej që sqarimet e nevojshme për vlerën reale të blerjes së apartamentit që janë dhënë në pyetësorin e dt. 16.04.2019, të ishin paraqitur nga ana ime në mënyrë të detajuar, që në plotësimin e deklaratës vetting. Kjo provohet nga statement bankar të lëshuar nga Banka Alpha [...]. Prandaj ritheksoj që unë nuk kam disponuar asnjëherë shumën prej 12.000 eurosh dhe as nuk kam paguar më shumë se 70.000 euro për blerjen e apartamentit.*
42. Komisioni, më datë 20.05.2019, nëpërmjet shkresës me nr. {***} prot., u ka kërkuar informacion shtetasve B. dhe A. K., në cilësinë e shitësve të pasurisë apartament me sipërfaqe 85 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, lidhur me vlerën e plotë të kontratës, mënyrën e shlyerjes së detyrimit kontraktor, kopje të mandatpagesave, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm lidhur me likuidimin përkatës të çmimit të kontratës.
Në përgjigje⁴ të kërkesës, shtetasit B., A. dhe V. K., informojnë Komisionin më datë 3.06.2019

⁴ Protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 03.06.2019.

se, para se të nënshkruanim këtë kontratë, palët kishin rënë dakord që apartamenti do t'u dorëzohej bashkëshortëve Hajro i mobiluar dhe sistem të kompletuar të ngrohje-ftohjes. Në këtë mënyrë, duke e konsideruar bashkë me mobilimin dhe me sistemin e ngrohje-ftohjes kishim rënë dakord edhe në kontratë për një vlerë prej 82.000 eurosh. Por pasi nënshkruam kontratën dhe shkruam për të parë fizikisht apartamentin, ne si bashkëpronarë arritëm në konkluzionin se nuk mund t'i plotësonim kërkesat e bashkëshortëve Hajro as për mobilimin dhe as për ngrohje-ftohjen e apartamentit. Atëherë ramë dakord që edhe mobilimin edhe sistemin e ngrohje-ftohjes së apartamentit, bashkëshortët Hajro do t'i bënin vetë. Për të mbuluar këto shpenzime, ne ramë dakord bashkarisht që shuma e këtyre shpenzimeve të ishte gjithsej 12.000 euro dhe bashkëshortët Hajro të na derdhnin gjithsej vetëm 70.000 euro.

Derdhjet në vlerën 70.000 euro janë bërë në datën 03.08.2007 pranë Alpha Bank për vlerën 55.000 euro dhe në datën 12.03.2008 pranë Alpha Bank në vlerën 15.000 euro, duke plotësuar kështu vlerën 70.000 euro të rënë dakord.

43. Nga krahasimi i informacionit të përcjellë nga shtetasit K. dhe i të dhënave të kontratë shitje me rezervë (pasuri e paluajtshme) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2007, trupi gjykues konstaton mospërputhje. Së pari, në objektin e kësaj kontrate nuk është parashikuar që apartamenti do t'u dorëzohej blerësve i mobiluar dhe me sistem ngrohje-ftohje. Së dyti, në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit dhënë Komisionit, nuk rezulton që subjekti të ketë pretenduar se vlera 70.000 euro ka qenë për arsye se apartamenti u dorëzua i pamobiluar apo pa sistem ngrohje-ftohje, por ka deklaruar se me palën shitëse arritën marrëveshje që vlera të shkruhej në kontratë 82.000 euro, me qëllim që të përfitonte kredi në vlerën që i korrespondonte sipas saj, dmth 70% e 82.000 euro në vlerën 55.000 euro dhe kredia për rikonstrukcionin 15.000 euro, që i është shtuar shumës së kredisë së parë, në total 70.000 euro. Subjekti sqaron se apartamenti i blerë ishte i ri, i përfunduar dhe nuk kishte nevojë për asnjë rikonstrukcion. Sa më sipër, rezulton se subjekti dhe shtetasit K. kanë mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me arsyen e pretenduar të vlerës 70.000 euro, si çmim për blerjen e apartamentit. Po kështu, asnjë nga palët nuk përmend pagesën e kështit të parë prej 7.000 eurosh, që sipas kontratës përcaktohet të jetë paguar ditën e nënshkrimit të kontratës, specifikisht citohet, sot më dt. 21.06.2007, blerësit Enkeledi Hajro dhe A. H. paguan kështin e parë të shitjes, në masën 7.000 euro.

44. Subjekti pretendon në ankim se Komisioni nuk ka administruar në cilësinë e provës, shkresën nr. {***} prot., datë 03.06.2019, që provon se apartamenti është shitur në shumën 70.000 euro, në kundërshtim me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, nenin 14, pika 5, shkronja "d" e ligjit nr. 84/2016, nenin 49, pikat 6, 7 dhe 9 të ligjit nr. 84/2016. Lidhur me vlerën provuese të deklarimit të palës shitëse, K., Komisioni qëllimisht ka shkëlur nenet 473 – 474 të Kodit Civil.

Trupi gjykues çmon se Komisioni nuk ka proceduar në kundërshtim me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, pasi vendimi ka qenë i arsyetuar, apo në kundërshtim me nenin 14, pika 5, germa "d" e ligjit nr. 84/2016, që parashikon detyrat e relatorit të çështjes. Gjithashtu, neni 49, pikat 6, 7 dhe 9 të ligjit nr. 84/2016, që konsistojnë në kërkesën për marrjen e provës dhe arsyet për refuzimin e saj, nuk gjejnë vend në pretendimin e subjektit, pasi shkresa drejtuar shtetasve K. nuk është kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, por nga Komisioni, në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, gjatë hetimit administrativ kryesisht. Sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk është i bazuar.

Sa i përket vlerës provuese të deklarimit të palës shitëse, shtetasve K., për të cilën subjekti pretendon se Komisioni qëllimisht ka shkëlur nenet 473 – 474 të Kodit Civil, trupi gjykues konstaton se parashikimet ligjore në nenin 473 dhe 474 të Kodit Civil nuk mbështetin

pretendimin e subjektit në ankim, pasi kanë të bëjnë me një situatë të ndryshme me atë të subjektit.

45. *Në ankim, subjekti pretendon se Komisioni ka përdorur standarde të ndryshme, duke mbajtur qëndrim të ndryshëm në vendimin nr. 57, datë 01.08.2018, i cili ka marrë formë të prerë kur është pranuar praktika e Alpha Bank, sipas së cilës në analizën financiare nuk është llogaritur çmimi i porositur në kontratën fillestare, por çmimi realisht i paguar.*

Lidhur me këtë pretendim, nga analizimi i vendimit nr. 57, datë 01.08.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. B. K., Komisioni nuk ka marrë në analizë çmimin e apartamentit sipas përcaktimit në kontratën e porosisë, por çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes, që është nënshkruar pas asaj të porosisë, ndërsa në rastin objekt gjykimi Komisioni me të drejtë ka marrë në konsideratë çmimin sipas kontratës së shitjes me rezervë, si kontrata e vetme e nënshkruar mes palëve kontraktore. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se Komisioni ka përdorur standarde të ndryshme, nuk është i bazuar.

46. *Subjekti pretendon në ankim se arsyetimi i Komisionit se deklarata e pasurisë vetting nuk është dokumenti i vetëm ku do të bazohet përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit, nuk është i mbështetur në ligj. Neni D, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës kanë normuar në mënyrë të qartë se në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve merret në vlerësim një deklaram i ri dhe, mbi bazën e këtij deklarami të ri, duhet të bëhet rivlerësimi mbi kriterin pasuror. Përndryshe, nëse deklaramet vjetore mbi pasurinë, të bëra për shkak të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, do ishin akte dokumentare mbi të cilat do të gjykonte Komisioni mbi kriterin pasuror të procesit të rivlerësimit, atëherë përse kushtetutëvënësi i ka dhënë të drejtën subjektit të rivlerësimit të paraqesë deklaratën përkatëse të pasurisë. Neni D i Aneksit të Kushtetutës, pikat 1 dhe 2 përcaktojnë qartë këtë normë kushtetuese që ka pasur synim matjen e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit.*

Sa i përket këtij shkak ankimor, nga analizimi i arsyetimit të Komisionit në vendim, në lidhje me procesin e vlerësimit të kriterit të pasurisë, sipas Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i këtij vlerësimi është deklarami dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Ndërsa sipas pikës 5 të nenit 32 të ligjit të sipërpërmendur, deklaramet e interesave privatë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni. Bazuar në këto përcaktime kushtetuese dhe ligjore, rezulton se deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit nuk është dokumenti i vetëm, i mjaftueshëm për vendimmarrjen e Komisionit, por deklaramet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni, nisur nga fakti që vërtetësia e të dhënave të deklaratës së pasurisë vetting, verifikohet dhe provohet nga dokumentacioni justifikues ligjor dhe nisur nga fakti që vetë ligji u njuh cilësinë e provës deklarative periodike ndër vite, të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, vlerësojmë të drejtë arsyetimin e Komisionit në vendim⁵.

Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “vetting” lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në vlerën 82.000 euro dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

⁵ Shih faqet 11 dhe 12 të vendimit nr. 154, datë 10.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

47. Arsyetimi i mësipërm për vlerësimin e kësaj pasurie, u bazua në aktet e mëposhtme.
- i. Deklarata “vetting” e vitit 2017 dhe dokumentacioni bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI.
 - ii. Deklaratat e interesave privatë periodikë të viteve 2007, 2009, 2014.
 - iii. Kontratë shitje me rezervë (pasurie e paluajtshme) me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2007.
 - iv. Shkresë nr. {***} prot., datë 05.07.2018, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë.
 - v. Kontratë për kufi kredie shumëqëllimore nr. {***}, datë 31.07.2007 (nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.07.2007) me Alpha Bank ShA.
 - vi. Shtesë e kontratës për kufi kredie shumëqëllimore nr. {***}, datë 31.07.2007, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.07.2007.
 - vii. Deklaratë nr. {***}, datë 12.09.2012, e Alpha Bank ShA.
 - viii. Kontratë kredie bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.09.2012.
 - ix. Kontratë kredie bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.09.2012.
 - x. Kontratë hipotekimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.09.2012.
 - xi. Informacion i shtetasve K., protokolluar në Komision me nr. {***}, më datë 3.6.2019.
 - xii. Dokumente të depozituara nga bankat e nivelit të dytë.
 - xiii. Provat të tjera shkresore të administruara nga Komisioni.

Për pasurinë automjet i markës “Hyundai”, tip “Tucson”

48. Komisioni, për këtë pasuri, ka arritur në përfundimet: *subjekti nuk ka deklaruar burimin e financimit për pasurinë automjet “Hyundai” në deklaratën “vetting”; subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, nuk arriti të provojë të ardhurat e ligjshme nga shitja e automjetit, tip “Skoda”, i cili është pretenduar si burim për blerjen e automjetit “Hyundai”; deklarimet e subjektit nuk përputhen me deklaratat periodike vjetore dhe me deklaratën “vetting”, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për periudhën e vitit 2010, në kohën e blerjes së automjetit tip “Hyundai”; Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në përputhje me pikat 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, është munduar dhe përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë të ardhurat e përfituara për pasurinë në pronësi të saj.*
49. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, makinë “Hyundai”, prodhim i vitit 2007, me targë {***}, në pronësi të bashkëshortit A. H., blerë me Tirana Leasing me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.12.2015. Vlera 20.000 euro. Për herë të parë blerja e këtij automjeti është deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2010, blerje e automjetit me kontratë leasing me Tirana Bank “Hyundai Tucson”, në vlerën 20.000 euro për 5 vjet, më datë 06.08.2010. Kësti mujor 223 euro. Referuar deklarimeve më sipër, rezulton se as subjekti i rivlerësimit dhe as personi i lidhur, bashkëshorti, nuk kanë deklaruar burimin e ligjshëm për likuidimin e shumës 9.000 euro si pagesë fillestare për blerjen e këtij automjeti “Hyundai”, tip “Tucson”, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
50. Nga të dhënat e përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me shkresën nr. {***} prot., datë 05.06.2018, konfirmohet se personi i lidhur A. H. aktualisht ka në

pronësi mjetin me targë {***} dhe ka pasur në pronësi mjetin me targë {***}. Referuar dokumentacionit të këtyre automjeteve, përcjellë nga kjo drejtori me shkresën nr. {***}prot., datë 21.06.2018, konfirmohet se në emër të bashkëshortit të subjektit është i regjistruar automjeti “Hyundai”, tip “Tucson”, me targë {***} dhe në emër të motrës së tij, D. H., automjeti “Skoda”, tip “Fabia”, me targë {***}.

51. Të dy automjetet – “Skoda”, tip “Fabia” dhe “Hyundai”, tip “Tucson” – janë përfituar me kontratë themelore të qirasë financiare (*leasing*), të nënshkruar mes shoqërisë Tirana Leasing ShA dhe bashkëshortit të subjektit, A. H., konfirmuar me shkresën nr. 3 prot., datë 07.02.2019, të Tirana Leasing ShA: *i) kontrata e qirasë financiare nr. {***}, datë 19.11.2008 (nr. {***} rep., nr. {***} kol.)*, me anë të së cilës është financuar me 7.000 euro për blerjen e një makine “Skoda Fabia”, me targë {***}, me vlerë blerjeje 10.000 euro. Me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.07.2010, e drejta e pronësisë është transferuar nga shoqëria “Tirana Leasing” ShA te z. A. H.; *ii) kontratë e qirasë financiare nr. {***} (nr. {***} rep., nr. {***} kol.) datë 18.08.2010*, me anë të së cilës është financuar me 11.000 euro për blerjen e një makine “Hyundai”, tip “Tucson”, me targë {***}, me vlerë blerjeje 20.000 euro. Me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.12.2015, e drejta e pronësisë mbi këtë automjet është transferuar nga shoqëria “Tirana Leasing” ShA te z. A. H.
52. Në përgjigjet e datës 23.01.2019, të pyetësorit shtesë të Komisionit, subjekti deklaroi se për blerjen e automjetit “Skoda Fabia”, në vlerën 10.000 euro, shuma prej 3.000 eurosh është paguar si kapital fillestar nga bashkëshorti, ndërsa 7.000 euro ka qenë vlera e kontratës së qirasë financiare që do të paguhej me këste për një kohëzgjatje 60 muaj. Sipas subjektit, në korrik të vitit 2010, është parapaguar dhe pjesa e kapitalit të mbetur, 5.210 euro, duke shlyer totalisht vlerën e automjetit. *Kjo shumë është financuar nga motra e bashkëshortit, D. H., e cila ka marrë në përdorim automjetin nga data 14.07.2010 deri në 31.07.2012, datë në të cilën ka paguar shumën prej 3.000 eurosh, duke fituar pronësinë mbi këtë mjet, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.07.2012. Në vitin 2010, që me mbylljen e kontratës së qirasë financiare leasing për automjetin “Skoda Fabia” dhe kalimin në përdorim motrës së tij, bashkëshorti i subjektit ka nënshkruar një kontratë të re leasing me Tirana Leasing ShA, për automjetin “Hyundai Tucson”, për një vlerë totale 20.000 euro, nga të cilat ka paguar fillimisht 9.000 euro (45% të vlerës totale – shih deklaratën noteriale të prindërve), ndërsa pjesën tjetër e ka shlyer me këste mujore të barabarta, për një kohëzgjatje prej 60 muajsh.*

Në rezultatet e hetimit paraprak, lidhur me të ardhurat nga automjeti “Skoda”, tip “Fabia”, Komisioni ka marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e shitjes së automjetit në vlerën 3.000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.07.2012, pasi financimet e tjera të deklaruara nga subjekti nuk dokumentohen nga dokumente shkresore provuese të kohës kur pretendohet financimi dhe as në deklaratat në deklaratat periodike vjetore. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaron se motra e bashkëshortit ka parapaguar vlerën 5.210 euro dhe pastaj është paguar si këst i dytë vlera 3.000 euro (sipas kontratës së shitjes). Subjekti pretendon se nuk ishte në dijeni të këtij fakti, për shkak se ka qenë një veprim i kryer në kuadrin e një marrëdhënieje të ngushtë familjare midis vëllait dhe motrës dhe nuk është deklaruar në deklaratat periodike. Subjekti ka depozituar, me përgjigjet e rezultateve të hetimit, *statement* të bankës Credins ShA për llogarinë në euro të znj. D. H. më datë 14.07.2010, në të cilën është disbursuar një kredi në vlerën 4.000 euro, si dhe dokumente të tjera bankare dhe punësimi (si librezë pune) për të provuar mundësinë financiare të motrës së bashkëshortit për të paguar vlerën 5.210 euro

më datë 14.07.2010 dhe vlerën 3.000 euro në vitin 2012.

53. Sipas subjektit në ankim, shuma 5.210 euro, e përdorur për shlyerjen e automjetit “Skoda”, tip “Fabia”, në vitin 2010, është paguar nga motra e bashkëshortit, D. H., e cila më datë 14.07.2010 ka marrë një kredi nga Credins Bank ShA, në vlerën 4.000 euro, kurse pjesa tjetër mbulohej nga të ardhurat e familjes së saj me dy prindërit.
54. Trupi gjykues, nga analizimi i deklaratave periodike vjetore, konstaton se as subjekti i rivlerësimit, as bashkëshorti nuk kanë deklaruar kontratën e qirasë financiare *leasing* nr. {***}, datë 19.11.2008 (nr. {***} rep., nr. {***} kol.) për automjetin “Skoda”, tip “Fabia” në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008, vlerën e kapitalit fillestar prej 3.000 eurosh të paguar, si dhe detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë Tirana Leasing ShA. Gjithashtu, as në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012 nuk është deklaruar shitja e automjetit nga personi i lidhur A. H. te motra e tij D. H., si detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 4, germa “b” dhe “dh” dhe në nenin 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, për të deklaruar burimin e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare për pasuritë e luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe detyrimin financiar ndaj personave juridikë, në lekë ose në valutë të huaj.
55. Lidhur me likuidikimin e shumës 5.210 euro, të pretenduar nga subjekti si të financuar nga D. H. më datë 14.07.2010, nga analizimi i deklaratës së interesave privatë të vitit 2010, trupi gjykues konstaton të jetë deklaruar vetëm: *blerje e automjetit, marka “Scoda”, në vlerën 10.000 euro, në pronësi të bashkëshortit A. H. [...] Kalimi i automjetit “Scoda” në pronësi de facto të D. H. (motra e bashkëshortit), e cila disponon një akt përdorimi, por nuk është deklaruar burimi financiar i ligjshëm i krijimit të pasurisë automjet “Skoda”, dhe as shuma 5.210 euro, e pretenduar si e financuar nga D. H.*
56. Referuar *lëvizjeve të llogarisë* në euro të D. H.s në bankën Credins ShA, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e rezultateve të hetimit, rezulton që D. H. të jetë financuar më datë 14.07.2010 nga kjo bankë, nëpërmjet kredisë në shumën 4.000 euro, kredi pa përshkrim qëllimi apo destinacioni për shumën e financuar, e cila është tërhequr *cash* nga D. H. po më datë 14.07.2010. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, me anë të të cilit të provojë se shuma e kredisë prej 4.000 eurosh, e tërhequr nga banka Credins ShA në *cash*, të jetë përdorur për të likuiduar këstin e parë prej 5.210 eurosh të çmimit të automjetit “Skoda”, tip “Fabia”, për më tepër kur likuidimi i automjetit, sipas të dhënave të përcjella nga shoqëria “Tirana Leasing” ShA me shkresën nr. {***} prot., datë 07.02.2019, rezulton të jetë kryer më datë 12.07.2010, pra dy ditë përpara disbursimit të kredisë nga Credins Bank ShA.
57. Sa i përket deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.01.2019, të shtetases D. H., përcjellë Komisionit nga subjekti me përgjigjet e datës 23.01.2019 të pyetësorit, e për të cilën ka kërkuar të merret si provë, trupi gjykues, me konsideratë qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit mbi deklaratat noteriale të mbajtura gjatë procesit të rivlerësimit, që nuk mbështeten apo harmonizohen me dokumente të tjera ligjore, për fakte të cilat nuk janë deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodikë, në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, e konsideron për pasojë si dokument me karakter deklarativ dhe joprovues, duke mos e marrë në konsideratë atë.

58. Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi, automjet “Hyundai”, tip “Tucson”, përfituar me kontratën e qirasë financiare nr. {***} (nr. {***} rep., nr. {***} kol.), datë 18.08.2010, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti, nuk kanë deklaruar burimin e ligjshëm për likuidimin e shumës 9.000 euro si pagesë fillestare për blerjen e tij, as në deklaratën e interesave private të vitit 2010 dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të dosjes, konstaton se me përgjigjet e datës 23.01.2019 të pyetësorit të Komisionit, subjekti depoziton deklaratën para noterit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.01.2019, të shtetasve S. dhe L. H., babai dhe nëna e bashkëshortit të subjektit, të cilët deklarojnë se në muajin gusht 2010, i kanë dhënë djalit të tyre A. H., shumën prej 8.000 eurosh, për shkak se ai ka hequr dorë nga trashëgimia në të ardhmen mbi shtëpinë në Gjirokastrë. *Megjithëse ky fakt nuk është formalizuar në letër, marrëdhënia familjare prindër-fëmijë bëri që t'i japim këtë shumë djalit tonë të vetëm.*
59. Subjekti, me përgjigjet e rezultateve të hetimit, ka përcjellë disa akte, për të cilat kërkon të administrohen si provë, që sipas tij provojnë aftësitë likuiduese të prindërve të bashkëshortit për të dhënë shumën prej 8.000 eurosh. Nga analizimi i këtij dokumentacioni, trupi gjykues konstaton se për shtetasin S. H. nuk është depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e tij, por është administruar dokumentacion, si: i) deklaratë e shtetasit L. M., sipas të cilit gjatë periudhës 1 tetor 1998 – 30 shtator 2007, i ka dhënë dr. S. H., për përdorim (pa qira), për shkak të lidhjes familjare, një ambient me sip. 20 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, të cilin konfirmon se e ka përdorur si klinikë dentare; ii) dy kërkesa dhe vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe asaj të Tiranës për regjistrimin si person fizik të kërkuesit S. H. për ushtrimin e aktivitetit privat si mjek stomatolog; iii) *statement të lëvizjeve të llogarive bankare në Bankën Raiffeisen ShA dhe Credins ShA për shtetasit L. H. dhe S. H..*
60. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarive të S. dhe L. H., përcjellë Komisionit nga banka Credins ShA me shkresën nr. {***} prot., datë 26.09.2018, rezulton që babai i bashkëshortit të subjektit të ketë pasur kursime në llogarinë e tij bankare pranë Credins Bank ShA: i) *në fund të vitit 2007, depozitë 6-mujore në shumën 300.000 lekë*, të cilën e ka transferuar në llogari dyemërore (S. dhe L. H.) në vitin 2008, si dhe depozitë e çelur më 23.10.2008, në shumën 10.001 euro, në llogari dyemërore; ii) *në fund të vitit 2008, S. dhe L. H. kanë pasur gjendje likuiditetesh në bankë 300.000 lekë dhe 10.001 euro*. Në fund të vitit 2009, shumën 200.000 lekë, plus 140.000 lekë, plus 5.450 euro. Në llogarinë e kursimeve në euro të S. dhe L. H., me gjendje shumën 5.506, 44 euro, D. H. ka transferuar më datë 27.01.2010, në depozitë 12-mujore në emër të prindërve, shumën 4.494,56 euro. Pra, në fund të vitit 2010, S. dhe L. H. kishin gjendje likuiditetesh në llogaritë e tyre bankare në Credins Bank ShA, shumën 100.000 lekë, plus 150.080 lekë, plus 10.001 euro. Nga llogaria dyemërore në euro, me balancë 10.001 euro më datë 31.12.2010, S. dhe L. H. kanë transferuar shumën 4.120 euro më datë 04.02.2011, në llogarinë e kredisë së D. H., për mbylljen e kredisë nr. {***} në Credins Bank ShA.
61. Nga analizimi analitik i kursimeve të prindërve dhe motrës së bashkëshortit të subjektit, gjendje në llogaritë e tyre bankare në Credins Bank ShA në fund të çdo viti të periudhës 2007-2010, nuk rezulton që S. dhe L. H. të kenë financuar në gusht 2010 birin e tyre në shumën e pretenduar, 8.000 euro, pasi nuk është kryer tërheqje për këtë qëllim dhe as nuk është depozituar dokumentacion ligjor provues për të. Shumat e tërhequra nga llogaritë janë përdorur për t'u ribllokuar në depozita me afat të prindërve të personit të lidhur, ose për të shlyer kreditë e së

bijës D. H. në gusht 2010 dhe shkurt 2011. Pra, nga analiza e kryer, dalim në përfundimin që pretendimi i subjektit për financimin e shumës 8.000 euro për të likuiduar shumën në *cash* të vlerës së automjetit “Hyundai”, tip “Tucson”, nuk qëndron.

62. Nga analizimi i deklaratës së interesave privatë të vitit 2010 dhe i deklaratës së pasurisë *vetting*, trupi gjykues nuk konstaton që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur të kenë deklaruar që nga pagesa fillestare 9.000 euro në *cash* pranë shoqërisë Tirana Leasing ShA, për blerjen e automjetit “Hyundai”, tip “Tucson”, shuma prej 8.000 eurosh është financuar nga prindërit e bashkëshortit, S. dhe L. H.. Për pasojë, në kushtet kur ky fakt nuk është materializuar në një dokument ligjor në kohën e dhënies së shumës së pretenduar, nuk është provuar me dokument justifikues ligjor që i është dhënë personit të lidhur për të blerë automjetin, nuk është deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2010, që në bazë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 shërben si provë në këtë proces, si dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues vlerëson se shuma prej 8.000 eurosh nuk plotëson kushtet për t’u konsideruar e ardhur e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
63. Në vijim të arsyetimit më sipër, duke mos marrë në konsideratë shumat 5.210 euro, pretenduar si e financuar nga D. H., dhe 8.000 euro, pretenduar si e dhënë nga S. dhe L. H., në Kolegj u krye analiza financiare për të provuar nëse subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme deri më 06.08.2010, për të paguar shumën 9.000 euro si pagesë fillestare e *kontratë e qirasë financiare nr. {***}, (nr. {***} rep., nr. {***} kol.) datë 18.08.2010*. Me konsideratë faktin që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar kursime vjetore apo të akumuluar në deklaratat e interesave privatë vjetore, analiza financiare u krye për periudhën 01.01.2010 deri në datën e likuidimit të shumës 9.000 euro, më 06.08.2010, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 1.323.764 lekë për likuidimin e kësaj shume, si pagesë fillestare në blerjen e automjetit “Hyundai”, tip “Tucson”, ndërsa për periudhën 01.01.2010 deri më 31.12.2010 mungesa e burimeve financiare rezulton në vlerën 906.756 lekë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
64. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se si burim krijimi për pasurinë automjet “Hyundai Tucson” ka deklaruar kontratën e qirasë financiare leasing, pasi nuk ishte në dijeni të faktit se duhej deklaruar dhe “burimi” i burimit për këtë automjet, duke bërë që pasaktësitë në deklaram nuk kanë ardhur për faj të subjektit pasi mungon ana subjektive, dashja/dijenia*. Trupi gjykues vlerëson të pabazuar këtë pretendim, pasi subjekti i rivlerësimit ka qenë person që mbart detyrimin për të deklaruar që prej vitit 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, dhe duhet ta dinte që burimi i krijimit konsiston në të ardhurat financiare të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve. Deklarimi nga ana e subjektit vetëm i kontratës së qirasë financiare *leasing* si burim krijimi, nuk është i plotë, pasi për këtë pasuri kanë shërbyer si burim krijimi edhe të ardhura të tjera, si pretenduar nga subjekti, të padeklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*.
65. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka mbajtur qëndrim ndryshe në vendimin nr. 105, datë 12.02.2019, lidhur me huanë, si dhe nuk ka përdorur të njëjtin standard si në vendimin nr. 13, datë 05.04.2018, në lidhje me barrën e provës, pasi nuk ka kryer asnjë analizë financiare në lidhje me aftësinë paguese dhe likuiduese të subjektit dhe të personave të lidhur për asnjë nga pasuritë e paluajtshme, duke pranuar të mirëqenë marrëdhënien shoqërore të subjektit me administratorin/ortakun e shoqërisë tregtare (faqe 6, paragrafi 6 dhe faqe 7, paragrafët 2 dhe*

3), ndërsa në lidhje me subjektin, znj. Enkeledi Hajro, nuk u pranua si e mirëqenë marrëdhënia juridike mes familjarëve të bashkëshortit, duke mos përdorur kështu të njëjtin standard në çmuarjen e provave dhe duke ngarkuar në mënyrë të padrejtë këtë subjekt, me barrën e provës.

Sa i përket këtij pretendimi, nga analizimi i dy vendimeve të përmendura nga subjekti në ankim, rezulton se në vendimin nr. 105, datë 12.02.2019 (faqe 26-29), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. E. T., në përfundim Komisioni ka vlerësuar se, *pavarësisht përshkrimit të gabuar të marrëdhënies së huasë midis shoqërisë në pronësi të bashkëshortit me atë të zotit P.S., duke paraqitur atë si marrëdhënie individuale, subjekti ka arritur të paraqesë prova dhe shpjegime bindëse për marrjen dhe shlyerjen e kësaj huaje nga “{***}” ShPK.* Nga arsyetimi i vendimit të Komisionit nr. 105, datë 12.02.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar huanë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007, ndërkohë që subjekti, znj. Enkeledi Hajro, nuk ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2010 shumën prej 5.210 eurosh, pretenduar t'i jetë dhënë bashkëshortit të subjektit nga e motra, D. H., dhe as shumën 8.000 euro, pretenduar të dhënë nga prindërit e bashkëshortit, S. dhe L. H..

Sa i përket vendimit nr. 13, datë 05.04.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. V. T.⁶, Komisioni ka arritur në konkluzionin se *pagesat për këtë apartament nuk janë kryer në rrugë bankare, apo në ndonjë formë që mund të verifikohet pagesa e tyre korrektësisht. Megjithatë, rezultoi se në tërësi të ardhurat e subjektit janë të mjaftueshme për të përballuar këto pagesa. Subjekti i rivlerësimit, znj. V. T., shprehet se marrëdhënia ndërmjet saj dhe shoqërisë “***” është, përveçse kontraktore, edhe mirëbesimi, për shkak të marrëdhënieve miqësore, rreth 25-vjeçare, me familjen e ortakut të shoqërisë.*

Nga arsyetimi i Komisionit në vendimin nr. 13, datë 05.04.2018, dhe konkluzioni i tij *se në përfundim të hetimit konstatohet nga trupa gjykuese se situata është e njëjtë me atë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit*, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova bindëse gjatë hetimit administrativ që kanë provuar deklaratimet e subjektit.

Nga analizimi i dy vendimeve të sipërcituara, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk është në të njëjtat kushte me rastet e përmendura dhe, për rrjedhojë, nuk vlerëson që Komisioni ka mbajtur qëndrime të ndryshme si pretendon subjekti. Bazuar në nenin 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, *Komisioni dhe Kolegji i Apelit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.* Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit që *Komisioni ka mbajtur dy qëndrime në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë së ligjit, në lidhje me provueshmërinë e marrëdhënies juridike të posaçme*, nuk është i bazuar.

66. Subjekti në ankim pretendon gjithashtu se në vendimin nr. 81, datë 26.11.2018, të Komisionit, me të njëjtin relator, është arsyetuar ndryshe, duke paraqitur si pjesë të pretendimit dhe paragrafët nr. 22.21, 23.4, 23.6.5, 23.7, 23.7.3, 23.8, 23.8.1, 23.9, marrë nga ky vendim i Komisionit. Trupi gjykues, nga analizimi i vendimit nr. 81, datë 26.11.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. F. P., konstaton *së pari* se, siç përcaktohet në paragrafin 22.19, subjekti, znj. F. P., është bërë për herë të parë subjekt deklarimi në ILDKPKI në vitin 2011, ndërsa Enkeledi Hajro në vitin 2003; *së dyti*, subjekti, znj. F. P., në deklaratën para fillimit të detyrës, si dhe në deklaratën *vetting* ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri. Ndërsa sa i përket blerjes së automjetit dhe dhënies së shumës 7.000 euro nga babai i subjektit, znj. F. P., nga analizimi i

⁶ Referoju vendimit nr. 13, datë 05.04.2018, të Komisionit (faqe 6, paragrafi 6 dhe faqe 7, paragrafët 2 dhe 3).

arsyetimit të vendimit të Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti, znj. F. P., këtë automjet e ka në bashkëpronësi me babain e saj, shuma 7.000 euro është paguar nga ky i fundit dhe mandatarkëtimi është lëshuar në emër të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, si dhe deklaratë noteriale të hartuar jo gjatë procesit të rivlerësimit, por në vitin 2011. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, nuk ndodhet në të njëjtat kushte me rastin e referuar prej saj dhe, për pasojë, pretendimi i saj është i pabazuar.

67. *Subjekti pretendon se edhe pse deklaratat vjetore periodike të pasurisë kanë vlerën e provës, ligjvënësi në nenin 233 të Kodit të Procedurës Civile, njeh veprimin juridik të bërë mes familjarësh edhe me gojë, si marrëdhënie juridike tërësisht në mirëbesim. Komisioni ka pretenduar vetëm prova shkresore, gjë që dëshmon hapur paragjykimin e çështjes së subjektit të rivlerësimit.*

Në analizë të këtij shkak ankimor, në kuptim të nenit 233, germa “ç” e Kodit të Procedurës Civile, lejohet prova me dëshmitarë: ç) kur për shkak të rrethanave në të cilat është kryer veprimi juridik ose të marrëdhënieve të posaçme të palëve, nuk ka qenë e mundur të merrej prova me shkresë. Edhe pse ligjvënësi nuk ka përcaktuar qartësisht se cilat marrëdhënie kategorizohen në marrëdhëniet e posaçme sipas këtij përcaktimi, por edhe sikur të konsiderojmë që marrëdhëniet familjare kategorizohen si të posaçme, përsëri trupi gjykues arrin në konkluzionin se prova me dëshmitarë, në kuadër të procesit të rivlerësimit, do të lejohej në ato raste kur subjekti do kishte deklaruar faktin që kërkon të provohet me dëshmitarë, në deklaratën e interesave privatë 2010 dhe në deklaratën e pasurisë “vetting”, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe do e kishte të pamundur të depozitonte provë tjetër shkresore të kohës së kryerjes së veprimit. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

Në përfundim, për pasurinë automjet, të markës “Hyundai”, tip “Tucson”, subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “vetting” lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, gerrat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

68. Arsyetimi i mësipërm për vlerësimin e kësaj pasurie, u bazua në aktet si më poshtë.

- i. Deklarata “vetting” e vitit 2017 dhe dokumentacioni bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së.
- ii. Deklaratat e interesave privatë periodikë të viteve 2008, 2009, 2010, 2012 dhe 2015.
- iii. Shkresë nr. {***} prot., datë 21.06.2018, e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- iv. Shkresë nr. {***} prot., datë 07.02.2019, e Tirana Leasing ShA.
- v. Kontratë e qirasë financiare nr. {***}, datë 19.11.2008 (nr. {***} rep., nr. {***} kol.), për automjetin “Skoda Fabia”.
- vi. Kontratë shitblerjeje e automjetit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.07.2010, mes shoqërisë “Tirana Leasing” ShA dhe z. A. H.
- vii. Kontratë e qirasë financiare nr. {***} (nr. {***} rep., nr. {***} kol.), datë 18.08.2010, për automjetin “Hyundai Tucson”.
- viii. Kontratë shitblerjeje e automjetit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.12.2015, mes shoqërisë “Tirana Leasing” ShA dhe z. A. H.
- ix. Prova të tjera shkresore të administruara nga Komisioni.

Për analizën financiare për vitet 2007, 2010, 2011, 2014 dhe 2015

69. Komisioni, pasi kreu analizën financiare për periudhën 2003-2016, për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të justifikuar me të ardhura nga burime të ligjshme pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera, *konstatoi se për vitet 2007, 2010, 2011, 2014 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në total në shumën prej 2.158.088 lekësh.*
70. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, pretendon se arsyetimi i Komisionit që subjekti nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjen e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato cash) dhe kryerjen e shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ajo ka ushtruar funksionin si gjyqtare, është i pabazuar në fakte dhe në ligj. Komisioni nuk i ka analizuar faktet e deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, duke mos analizuar se pasuritë e vëna nga subjekti i rivlerësimit, nuk i referohen gjithë periudhës që ajo ka qenë si gjyqtare, pasi pjesa më e madhe e pasurive janë vënë kur ajo nuk ka qenë gjyqtare.*
71. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht faktit që subjekti i rivlerësimit është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë më 10.07.2014, procesit të kontrollit i nënshtrohen të gjitha pasuritë e deklaruar nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë vetting, përfshirë ato të krijuara para emërimit si gjyqtare, për më tepër kur subjekti i rivlerësimit që prej vitit 2003, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9049/2003, ka qenë subjekt deklarues në ILDKPKI dhe pasuritë e krijuara gjatë kësaj periudhe janë objekt rivlerësimi. Trupi gjykues e gjen të drejtë arsyetimin në vendimin e Komisionit se: *nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive synohet identifikimi i subjekteve të rivlerësimit, të cilat janë bërë përfutuese apo përdoruese të pasurive në mënyrë të paligjshme, apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj.*
72. *Subjekti pretendon se balanca negative e Komisionit për vitin 2007 lidhet me mosnjohjen e vlerës reale të blerjes së apartamentit prej 70.000 eurosh dhe jo 82.000 eurosh. Për provat e paraqitura nga subjekti për të provuar këtë fakt, nuk është bërë analizë ligjore nga Komisioni, duke refuzuar njohjen e fuqisë të tyre provuese dhe duke i ngarkuar subjektit barrën e provës për shumën 12.000 euro e, për pasojë, duke e llogaritur si burim të paligjshëm, që ka rezultuar me balancë negative të padrejtë. Trupi gjykues e ka analizuar këtë shkak ankimor në vlerësimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 85 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, më sipër në këtë vendim.*
73. Për pretendimin e subjektit se: *balanca negative në vitin 2010 ka ardhur pasi Komisioni ka refuzuar të pranojë ligjshmërinë e shumës prej 5.210 eurosh, të paguar nga motra e bashkëshortit të subjektit, me qëllim shlyerjen e vlerës së mbetur të qirasë financiare për blerjen e automjetit “Skoda”, tip “Fabia”, si dhe burimin e shumës prej 8.000 eurosh, kursime nga të ardhurat e prindërve të bashkëshortit dhënë këtij të fundit, vlerësimi i trupit gjykues gjendet në analizimin e pasurisë automjet “Hyundai”, tip “Tucson”, më sipër në këtë vendim.*
74. *Për balancën negative në vitin 2011, subjekti pretendon të ketë ardhur pasi nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e subjektit i) të përfuturara nga dietat e financuara nga*

Këshilli i Evropës, në shumën 175 euro/ditë, të deklaruar në pyetësorin e parë, të cilat janë kursyer nga subjekti pasi është akomoduar në selinë e Misionit të Republikës së Shqipërisë në Strasburg, pa pasur kosto/shpenzime të tjera, duke kursyer 600 euro; ii) të ardhurat nga dietat e udhëtimit zyrtar në Kolumbi, Kartagjenë (100 dollarë/ditë), në datat 29.11.2011 – 05.12.2011, të paguara nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, duke kursyer gjithë dietën 700 dollarë amerikanë.

Referuar jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues ka mbajtur qëndrim konstant lidhur me të ardhurat nga dietat, duke i konsideruar ato vlera monetare të destinuar për t'u përdorur për një qëllim të caktuar, për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme profesionale, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Nëse këto shuma, sipas pretendimit të subjektit në ankim, do të ishin kursyer, atëherë subjekti duhet t'i kishte deklaruar si kursime, likuiditete në *cash* apo në bankë, në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011, në përputhje me nenin 4, germa "d" e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar. Nga analizimi i deklaratave të interesave privatë periodikë, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar kursime në *cash* në asnjë deklaratë periodike apo në deklaratën e pasurisë *vetting*. Nëse këto kursime janë depozituar në llogari bankare, atëherë janë përfshirë në përlllogaritje në zërin *ndryshim i gjendjes së likuiditeteve në llogaritë bankare*, duke u bërë pjesë e analizës financiare.

75. *Subjekti pretendon se balanca negative e vitit 2014 ka ardhur si rezultat i faktit që subjekti ishte i pa punë dhe është ndihmuar si gjithmonë nga daja G. Sh., i cili e ka ndihmuar duke u dhënë shumën prej 120.000 lekësh dhe në vazhdimësi fëmijëve të subjektit. Subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të z. G. Sh., meqë shuma ka qenë nën vlerën 300.000 nuk kishte detyrim ligjor të deklarohet.*

Trupi gjykues, pavarësisht deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.09.2019, të paraqitur nga subjekti, për të cilën ka mbajtur një qëndrim (paragrafi 57 i këtij vendimi), në kushtet kur nuk rezulton të jetë depozituar në dosje dokumentacion justifikues ligjor që të provojë dhënien e shumës prej 120.000 lekësh nga daja i subjektit, si dhe nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2014, kjo e ardhur nuk përmbush kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nuk është përlllogaritur në analizën financiare të kryer për vitin 2014.

76. *Pretendimi i subjektit se vlerat e vogla të balancave negative tregojnë në fakt se shkaku i tyre konsiston në relativitetin e përlllogaritjeve financiare, dhe se kalimi i një periudhe të gjatë kohore vështirëson së tepërmi përlllogaritjen e saktë të balancave, trupi gjykues vlerëson se nuk qëndron. Periudha e gjatë kohore nuk ndikon në diferencat negative të përlllogaritura, nisur nga fakti se të dhënat për analizën financiare të kryer, janë marrë nga deklaratimet e subjektit dhe personit të lidhur në deklaratën e interesave privatë periodikë të çdo viti, duke filluar nga viti 2003 deri në vitin 2016, si dhe në deklaratën për rivlerësimin e pasurisë *vetting*, të provuar me dokumentacion justifikues ligjor. Nëse subjekti dhe personi i lidhur deklarojnë saktë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, të ardhurat, pasuritë e krijuara, kursimet e realizuara, shpenzimet e deklarueshme, shtesat dhe pakësimet e pasurive, detyrimet financiare, rezultati financiar i përlllogaritur si diferencë e të ardhurave me pasuritë neto dhe shpenzimet e kryera do të rezultonte zero. Subjektet nuk mund të krijojnë pasuri apo të kryejnë shpenzime në vit me vlerë/kosto më të lartë se të ardhurat nga burime të ligjshme të përfituara gjatë vitit, përfshi këtu përdorimin e kursimeve të akumuluar nga vitet e mëparshme, të cilat duhet të jenë deklaruar, sipas parashikimeve të nenit 4, germa "d" e ligjit nr. 9049 dhe të nenit D,*

pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Sipas logjikës së përdorur për vitet në të cilat analiza financiare e kryer ka rezultuar me diferencë negative, subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, duhet të paragjykonte edhe rezultatet për vitet kur diferenca të ardhura minus pasuri neto, minus shpenzime, ka rezultuar pozitive. Bazuar në sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues e gjen të paargumentuar pretendimin e subjektit.

77. Për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të, për të justifikuar me të ardhura nga burime financiare të ligjshme, pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera për periudhën 2003 – 2016, bazuar në konkluzionet e arritura nga trupi gjykues pas analizimit dhe vlerësimit ligjor të shkaqeve të ankimit, u krye analiza financiare në Kolegj, rezultatet e së cilës konfirmuan vlerën negative të përllogaritur nga Komisioni.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe shpenzimeve të kryera, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

78. Arsytimi i mësipërm u bazua në aktet e mëposhtme.

- i. Deklarata e pasurisë (vetting) 2017, së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur.*
- ii. Deklarata e pasurisë për herë të parë, në vitin 2003.*
- iii. Deklaratat e interesave privatë për vitet 2004 - 2016.*
- iv. Shkresa nr. {***} prot., datë 04.03.2019, e ILDKPKI-së.*
- v. Dokumentacioni i përcjellë nga bankat e nivelit të dytë.*
- vi. Shkresa nr. {***} prot., datë 04.03.2019, e ILDKPKI-së.*
- xiv. Provat shkresore të administruara nga Komisioni.*

79. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe pasi shqyrtoi provat e administruara në këtë çështje, arrin në përfundimin se:

*Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe funksionale 85 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “vetting” lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në vlerën 82.000 euro dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, gerrat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.*

Për pasurinë automjet i markës “Hyundai”, tip “Tucson”, subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “vetting” lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, gerrat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

Për analizën financiare për vitet 2007, 2010, 2011, 2014 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe për shpenzimet e kryera, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

80. Trupi gjykues, në mbështetje të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerëson se vendimi nr. 154, datë 10.06.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 154, datë 10.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 26.01.2021.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi – kundër

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Ina Rama, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues në çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, kundër vendimit nr. 145, datë 10.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nëpërmjet të cilit është vendosur lënia në fuqi e vendimit të mësipërm të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra e gjyqtares të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro. Kam votuar për ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, me funksionin gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Më poshtë do të rendis arsyet e votës kundër, duke u ndalur dhe arsyetuar qëndrimet e mia kundër konkluzioneve që ka mbajtur shumica e trupit gjykues në këtë çështje, konkluzione të cilat më kanë çuar në formimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në drejtim të vlerësimit të kontrollit të pasurisë, për pasojë ky kriter i procesit të rivlerësimit për të duhej të vlerësohej në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”) dhe, konsideruar së bashku me vlerësimin në nivel besueshëm e të përshtatshëm për të dyja kriteret e tjera, atë të figurës dhe të aftësive profesionale, të cilin e ka konkluduar edhe vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi, më kanë çuar në përfundimin se subjekti duhej konfirmuar në detyrë, pasi në mënyrë kumulative plotësonte të tria kushtet e parashikuara prej nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave vendoset konfirmimi në detyrë për subjektet e rivlerësimit.
3. Ndryshe nga shumica e trupit gjykues, kam arritur në një konkluzion tjetër për sa i përket vlerësimit për vërtetësinë e deklarimeve dhe burimeve të ligjshme të përdorura prej subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 85 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë.

3.1 Duke iu referuar fakteve të cituara në vendim, rezulton se subjekti në lidhje me këtë pasuri, në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar: *Apartament banimi në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe funksionale 85 m², e ndodhur në rr. “{***}” Nd {***}, H{***}, Ap. {***}, Tiranë, blerë me kredi të marrë nga “Alpha Bank” 70.000 euro, sipas marrëveshjes në kontratën e shitjes me rezervë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2007, për vlerën 82.000 euro, pasi banka mbulonte vetëm 70% të vlerës së blerjes së apartamentit, dhe Kontratës së Kredisë për blerje apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.07.2007. Kjo kredi është blerë nga BKT në shtator 2012 në vlerën 8.600.000 lekë, e cila përbëhet nga dy kredi: njëra shtetërore 5.000.000 lekë, me interes fiks 4%, dhe tjetra kredi tregtare në vlerën 3.600.000 lekë, me interes të ndryshueshëm. Në rubrikën e vlerës së pasurisë, subjekti ka deklaruar për këtë pasuri vlerën 82.000 euro.*

3.2 Në zbatim të parashikimit të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, detyrë e organeve të rivlerësimit është verifikimi i deklarimeve të subjektit në deklaratën *vetting* dhe, pas një leximi të saktë dhe korrekt të këtyre deklarimeve, të kontrollohet nëse subjekti ka pasur mundësi që me burime të ligjshme të ketë krijuar pasurinë e deklaruar.*

3.3 Mbi këtë parashikim ligjor, kam vlerësuar se detyrë e organeve të rivlerësimit, Komisionit në radhë të parë, në fazën e hetimit administrativ, dhe Kolegjit si organ gjyqësor që shqyrton ankimin e subjektit, është së pari leximi dhe kuptimi i qartë i deklaramit të subjektit në deklaratën *vetting* dhe më pas verifikimi i vërtetësisë së këtij deklarimi përmes të gjitha fakteve që burojnë të evidentuara nga burimet e njohura të provës, sipas përkufizimeve të ligjit nr. 84/2016, posaçërisht parashikimit të neneve 32/5 e nenit 49 të tij.

3.4 Në funksion të sqarimit të këtij deklarimi përgjatë procesit të rivlerësimit të zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, ka deklaruar se qëllimi i saj në këtë formë deklarimi ka qenë të pasqyrojë në deklaratën *vetting* situatën reale që lidhet me aspektin formal të dokumentimit të marrëdhënies juridike për fitimin e pronësisë mbi këtë pasuri nga shitësit, bashkëpronarët e familjes K. dhe, nga ana tjetër, të deklarojë në mënyrë korrekte vlerën reale dhe çmimin e paguar për blerjen e kësaj pasurie, duke përcaktuar gjithashtu edhe burimin e krijimit të të ardhurave për financimin e kësaj pasurie nga kredia e përfituruar nga banka “Alpha Bank” si fillim e më pas nga banka BKT për një pjesë të kredisë.

3.5 Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, përgjatë hetimit dhe pretendimeve të saj të ngritura në formën e shkaqeve të ankimit ndaj vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, vlera reale e blerjes së këtij apartamenti, është vlera prej 70.000 eurosh dhe shënimi në kontratën e shitblerjes së tij për vlerën 82.000 euro ka ndodhur për shkak të mundësisë të financimit të çmimit të blerjes krejtësisht me kredinë bankare dhe pasqyrimin në kontratë të një vlere më të madhe për blerjen e këtij apartamenti, duke mundësuar kreditimin e plotë të shumës prej 70.000 eurosh prej bankës, në zbatim të protokolleve bankare, sipas të cilave financohej me kredi vetëm për mbulimin e blerjes së një pasurie deri në 70% të vlerës së saj. Ky shpjegim i subjektit afekton, nëse pranohet si i vërtetë, edhe analizën financiare që kryhet për kontrollin e burimeve të ligjshme të përdorura prej saj për blerjen e kësaj pasurie.

3.6 Në analizë të të gjitha të dhënave që vijnë nga aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ dhe çmimit e vlerësimit të tyre në raport me njëra-tjetrën, në funksion të përcaktimit të vlerës provuese të secilës provë e krijimit të bindjes së brendshme, kam arritur në konkluzionin se deklaramet e subjektit për kronologjinë e fakteve, sipas shpjegimeve të saj, janë bindëse dhe të vërteta, pavarësisht një lloj paqartësie e mungese kohezioni apo kaotizmi në drejtim të gjuhës të ndërtuar jo krejtësisht mirë, të diktuar në vlerësimin tim edhe nga kompleksiteti i vetë natyrës së transaksionit të deklaruar por që pavarësisht, të krijojnë bindjen rreth vërtetësisë së tyre.

3.7 Për të arritur në këtë konkluzion, në kuptim edhe të parashikimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: *Komisioni dhe Kolegji i Apelitit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes*, kam çmuar në raport dhe harmoni me njëra-tjetrën të dhënat që kanë buruar kryesisht nga deklaramet periodike të pasurisë, të cilat janë vlerësuar në mënyrë të posaçme si prova në kuptim të nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, që parashikon se: *Komisioni ose Kolegji i Apelitit, sipas rastit, përmes personelit të tyre, Komisionerit Publik ose vëzhguesit ndërkombëtar, shqyrton deklaramet e subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij [...], si edhe nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: Deklaramet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelitit*, e mbi analizën e të cilave ndërtohet

përgjithësisht e gjithë procedura hetimore e këtij procesi për të vlerësuar dy elementet përbërëse të kriterit të pasurisë, vërtetësia e deklarimeve dhe verifikimi i burimit të ligjshëm për krijimin e këtyre pasurive.

4. Në mbështetje të këtij vlerësimi qëndrojnë faktet e renditura në vijim, të cilat, sipas analizës e çmimit të tyre, më kanë çuar në krijimin e bindjes si është përshkruar më lart.

4.1 Rezulton se subjekti e ka fituar pronësinë mbi këtë pasuri në vitin 2007, kohë në të cilën ajo nuk ushtronte detyrën e gjyqtarës, por punonte pranë Ministrisë së Drejtësisë⁷ dhe ishte për këtë shkak subjekt deklarues në kuptim të ligjit nr. 9349/2003 dhe, për pasojë, e ka deklaruar këtë pasuri së pari në deklaratën periodike të vitit 2007, te rubrika e deklarimeve të personave të lidhur, në emër të bashkëshortit të saj, si: *apartament banimi me sipërfaqe 85 m² (2+1) në rr. “{***}”, kompleksi {***}, shk. {***}, kati i {***}*¹², me kontratë shitjeje me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2007 [...], në vlerën 82.000 euro. Pjesa takuese ½, me bashkëshortin.

4.2 Më pas, subjekti ka vijuar të bëjë deklarime për këtë pasuri edhe në deklaratën periodike të vitit 2009. Në këtë deklaratë, subjekti ka rideklaruar pasurinë shprehimisht si: *apartament banimi 85 m², rr. “{***}”, hyrja {***}, Ap. {***}. Vlera 70.000 euro. Pjesa takuese 50%*. Që në këtë vit, subjekti fillon të deklarojë në mënyrë konsekuente vlerën prej 70.00 eurosh të kësaj pasurie, vlerë të cilën ajo e deklaron edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, edhe në shpjegimet e saj dhe e ngre si pretendim në ankimin e ushtruar pranë Kolegjit.

4.3 Subjekti vijon të deklarojë për këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2014 e në deklaratën përpara fillimit të detyrës së gjyqtarës po në këtë vit, duke shpjeguar në këtë kohë, burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe blerjen e kredisë tregtare nga Alpha Bank te BKT, me kushtet e një kredie të butë, të akorduar në zbatim të VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”. Subjekti në këtë vit ka deklaruar në rubrikën e shtesave dhe ndryshimeve të pasurisë: *blerje me kredi tregtare pranë Alpha Bank, në vitin 2007 e një apartamenti banimi me sip. 85 m², në rr. “{***}”, Tiranë. Nd. {***}, Ap. {***}, në vlerën 70.000 euro. Kjo kredi është blerë nga BKT në 2012 për vlerën 8.600.000 lekë, me afat 20 vjet, interesi 4% (kredi shtetërore) dhe 7,99% i ndryshueshëm (kredi tregtare), me këste mujore sipas kontratave dhe listëpagesës bashkëlidhur, në pronësi të përbashkët me bashkëshortin, me nga ½ pjesë takuese. Në vlerën 70.000 euro, 8.600.000 lekë.*

Ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2015, subjekti ka deklaruar në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë: *blerje me kredi tregtare pranë Alpha Bank në 2007 e një apartamenti banimi me sip. 85 m², në rr. “{***}”, Tiranë [...], në vlerën 70.000 euro. Kjo kredi është blerë nga BKT në 2012.*

4.4 Nga analizimi i deklarimeve të mësipërme, rezultojnë dy elemente që persistojnë në deklaratimet e saj. *Së pari*, subjekti i rivlerësimi, duke filluar që nga deklaratimet periodike të viteve 2009, 2012, 2014, 2015, si edhe në deklaratën *vetting*, deklaron si vlerë të blerjes së aparatamentit, vlerën prej 70.000 eurosh, duke deklaruar paralelisht se në kontratë është përshkruar vlera prej 82.000 eurosh si çmim i blerjes, në funksion të përfitimit të një kredie që

⁷ Shih vendimin e Komisionit nr. 154, datë 10.06.2019, “Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare” paragrafi b/ (i), tek i cili jepen të dhënat e punësimit të subjektit të rivlerësimit.

mbulon 100% vlerën e blerjes së apartamentit. *Së dyti*, subjekti nuk ka deklaruar në asnjë deklaram të saj, qoftë periodik apo atë të pasurisë *vetting*, një burim të ndryshëm krijimi për këtë pasuri, përveç se kredisë së përfituar nga banka. Në këtë logjikë, nëse vlera reale e blerjes së pasurisë do të ishte ajo prej 82.000 eurosh, mbështetur në një matematikë të thjeshtë, subjekti, qoftë edhe për një çast të vetëm sinqeriteti, kur nuk kishte filluar të aplikonte skemën e përdorimit të kredisë si burimin e vetëm për financimin e kësaj pasurie, duhej të kishte lënë gjurmë për një burim shtesë apo alternativ për të mbuluar diferencën e vlerës, veçanërisht në një kohë kur koncepti i detyrimit të verifikimit të burimeve të ligjshme qoftë të subjekteve deklaruese apo të personave të tjerë të lidhur me ata, nuk ekzistonte në nivelin e përcaktuar në ligjin *vetting* dhe as nuk parashikohej se do të ngrihej ndonjëherë në këtë nivel. Përkundrazi, subjekti konstatohet se ka qenë këmbëngulëse dhe persistente në deklaramin si burim të vetëm të krijimit të kësaj pasurie kreditimin nga sistemi bankar, kreditim i cili rezulton të jetë kryer në të njëjtat terma e kushte siç subjekti deklaron.

4.5 Gjithashtu, nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk ka rezultuar asnjë gjurmë tjetër, në asnjë formë, për pagesa të tjera të kryera nga subjekti te shitësit e pronës, që të provojnë pagesa të çmimit sipas vlerës së përcaktuar në kontratën e shitblerjes. Në mbështetje të kësaj skeme, vijnë edhe deklaramet e shitësve të pasurisë, shtetasit B. K., A. K. e V. K., të cilët deklarojnë se e vetmja vlerë që kanë përfituar nga subjekti është ajo e marrë me kredinë bankare prej 70.000 eurosh, vlerë e konfirmuar edhe sipas dokumentacionit të përcjellë nga banka “Alpha Bank” për këtë qëllim.

4.6 Përtej konstatimit se përpilimi i një kontrate me të dhëna jo të sakta, në funksion të arritjes së qëllimit për të përfituar maksimalisht vlerën e një kredie bankare, nuk demonstroi një sjellje që do të plotësonte standardet më të larta etike për një magjistrat, por që duhet vlerësuar gjithsesi në kontekstin e rrethanave në të cilat ka ndodhur, siç janë fakti që subjekti në atë në kohë nuk ka qenë në ushtrim të detyrës së gjyqtarës, por edhe sikur të ishte në atë detyrë, veprimtaria e analizuar do të ishte gjithsesi në çdo rast një sjellje jashtëgjyqësore, kam çmuar se deklaramet e subjektit për këtë vlerë të pasurisë janë të vërteta dhe se kjo vlerë duhet llogaritur si shpenzim në analizën financiare të subjektit dhe jo vlera prej 82.000 eurosh, e deklaruar në kontratën e shitjes.

4.7 Krahas këtyre deklarameve në deklaramin e pasurisë *vetting* dhe atyre në deklaramat periodike dhe deklarameve të palëve në kontratën e shitblerjes, vlen të analizohet edhe fakti që deklaramet e subjektit për vlerën e pasurisë në masën prej 70.000 eurosh mbështeten edhe nga deklaramet e shitësve të pronës, në shkresën e datës 03.06.2019, kthyer si përgjigje shkresës së nisur drejt tyre me nr. {***} prot., datë 20.05.2019, prej Komisionit gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet të cilës ata pohojnë se e vetmja vlerë e përfituar prej blerësve, subjekti dhe bashkëshorti i saj, ka qenë vlera prej 70.000 eurosh, e cila ka qenë edhe çmimi real i transaksionit.

Në lidhje me vlerën provuese të këtij deklarami, mendoj se përcaktimi i saj nuk duhet të referojë vetëm në dispozitat ligjore të cituara nga shumica, të cilat në vlerësimin tim nuk janë përjashtuese, por rregullatore në situata të tilla dhe me fuqi detyruese mes vetë palëve, por duhet të konsiderohet dhe vlerësohet në raport me rrethanat konkrete të çështjes.

4.8 Parashikimi i nenit 193, pika “b” e Kodit Civil, sipas të cilit duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme: [...] b) kontratat me të cilat krijohen, njihen, ndryshohen ose pushojnë të drejta pronësie mbi sendet e paluajtshme, të drejta uzufukti, përdorimi e bujtjeje,

emfiteoze e servituti e të drejta të tjera reale [...] nuk zgjidh situatën në diskutim, për sa kohë kontrata e shitblerjes me anë të së cilës palët kanë kaluar pronësinë mbi pasurinë, është e regjistruar në regjistrin e pasurisë të paluajtshme sipas këtij parashikimi ligjor dhe asnjë prej palëve të kontratës apo ndonjë palë e tretë nuk ka pretendime në lidhje me këtë veprim juridik. Faktet e deklaruara prej subjektit dhe palës shitëse në lidhje me çmimin e përcaktuar në kontratë, nuk afektojnë të drejtat e pronësisë së fituara nga pala blerëse mbi këtë pasuri dhe as humbjen e këtyre të drejtave nga pala shitëse dhe as cenojnë sigurinë juridike në raport me të tretët që janë vënë në dijeni të këtij transaksioni. Regjistrimi i pasurisë sipas kësaj dispozite ka siguruar kalimin e së drejtës së pronësisë, në kuptim formal, nga shitësi te blerësi dhe ka garantuar të drejtën e çdo pale të tretë që mund të ndërveprojë për shkak të ndodhjes së këtij fakti juridik, duke përmbushur në këtë mënyrë edhe qëllimin e kësaj dispozite. Saktësimi apo përcaktimi i çmimit me marrëveshje të palëve, për sa kohë që provohet se ka ndodhur, nuk cenon marrëveshjen e palëve për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe as cenon zbatimin e nenit 193, pika “b” e Kodit Civil.

4.9 Në vijim të këtij arsytimi, duke u mbështetur në prezumimin ligjor që palët mund të modifikojnë vullnetet e tyre, për sa kohë që nuk afektohen të drejtat e të tretëve prej këtij modifikimi, mbetet një çështje provueshmërie kryerja e veprimit të pretenduar. Në kontekst të procesit të rivlerësimit, i cili nuk është një proces i natyrës civile ku rregullat procedurale civile që garantojnë të drejtat procedurale të palëve në një konflikt civil, kanë fuqinë e tyre detyruese dhe kondicionojnë procesin e të provuarit, mendoj se analiza e të dhënave që vijnë për shkak të hetimit administrativ, duhet të realizohet në përputhje me dispozitat procedurale civile në fuqi për aq sa ato gjejnë zbatim, duke potencuar analizën e këtyre të dhënave në kontekst dhe funksion të këtij procesi, analizë e cila është e individualizuar sipas fakteve të çdo rasti konkret.

4.10 Në këtë kuptim, duke marrë në konsideratë të gjitha faktet e cituara më lart dhe argumentin ligjor për diskrecionin dhe zbatimin *mutadis mutandis* të dispozitave procedurale, edhe në këndvështrim të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 që parashikon se: *Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji*, kam krijuar bindjen, në zbatim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, se deklaratimet e subjektit për vlerën e pasurisë apartament, në masën 70.000 euro, duhen konsideruar të vërteta dhe se në këto kushte, deklaratimet e bëra në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk përfaqësojnë pasaktësi të tilla që të mund të kualifikohen sipas interpretimit *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e këtij ligji, si deklaratime të pasakta.

4.11 Në vijim të këtij konkluzioni, modifikohet edhe rezultati i analizës financiare të kryer sipas kësaj të dhëne, duke pasur për subjektin e rivlerësimit një analizë financiare pozitive për këtë vit.

5. Kam dalë në një konkluzion të ndryshëm nga shumica edhe në lidhje me verifikimin e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit për automjetin e markës “Hyundai”, tip “Tuscon”, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* si: *prodhim i vitit 2007, me targë {***}, në pronësi të bashkëshortit A. H., blerë me Tirana Leasing me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.12.2015. Vlera 20.000 euro.*

5.1 Gjatë shpjegimeve të dhëna në fazën e hetimit administrativ, rezulton se subjekti ka deklaruar se në vitin 2012, në të cilin është lidhur kontrata e qirasë financiare me shoqërinë Tirana Leasing për marrjen nën këtë regjim të automjetit të markës “Hyundai”, bashkëshorti i saj i ka kaluar në përdorim, me qëllim blerjen në të ardhmen motrës së tij, automjetin tip “Skoda”, të cilin ai e dispononte po për shkak të një marrëdhënieje *leasing* me të njëjtën shoqëri që prej vitit 2008. Subjekti ka deklaruar se për shlyerjen e detyrimit me shoqërinë Tirana Leasing në vitin 2010, në vlerën prej 5.210 euro, që përfaqësonte edhe të gjithë detyrimin e mbetur shoqërisë, janë përdorur paratë e motrës së bashkëshortit.

5.2 Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2010, lidhjen e kontratës *leasing* me shoqërinë Tirana Leasing për automjetin “Hyundai” dhe mbylljen e marrëdhënies *leasing* me këtë shoqëri për automjetin tip “Skoda” të përfunduar me blerjen e tij si vijon: *Blerje e automjetit marka “Scoda” në vlerën 10.000 euro, në pronësi të bashkëshortit A. H. [...]. Kalimi i automjetit “Scoda” në pronësi de facto të D. H. (motra e bashkëshortit), e cila disponon një akt përdorimi.*

5.3 Nga hetimi, ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka lidhur një kontratë shitblerjeje me motrën e tij D. H. për automjetin tip “Skoda” në vitin 2012 për vlerën 3000 euro, vlerë e cila sipas subjektit përfaqëson vlerën e mbetur pa paguar të automjetit në raport me çmimin që ai është marrë në pronësi prej motrës së bashkëshortit, e cila nga ana e saj kishte paguar diferencën prej 5210 eurosh që në vitin 2010, në momentin kur ky automjet i kaloi asaj në përdorim, ose “pronësi de facto”, si e përshkruan subjekti në deklaratën periodike të vitit 2010.

5.4 Ndryshe nga qëndrimi që ka mbajtur shumica, kam vlerësuar se pavarësisht faktit se subjekti nuk ka deklaruar saktë burimin e krijimit të pasurisë “Hyundai” në deklaratën e pasurisë *vetting*, shpjegimet e dhëna prej saj gjatë hetimit administrativ, se motra e subjektit ka paguar shumën prej 5210 eurosh në kohën që ajo ka marrë në dorëzim automjetin tip “Skoda”, është një shpjegim i logjikshëm dhe bindës dhe mbështetet në deklarinimin që ajo ka bërë në deklaratën e periodike të vitit 2010, si edhe në kontratën e shitblerjes së automjetit në vitin 2012. Fakti që në deklaratën periodike të vitit 2010 subjekti ka deklaruar “pronësinë de facto” të motrës së bashkëshortit mbi këtë automjet, ndonëse jo një term ligjor e i përshtatshëm për të përkufizuar ligjërisht marrëdhënien në fjalë, hedh dritë dhe evidenton faktin se mes bashkëshortit të subjektit dhe motrës së tij është lidhur një marrëveshje për kalim të drejtash në raport me automjetin tip “Skoda”. Kjo marrëveshje për kalimin e këtyre të drejtave nuk është e shoqëruar në këtë kohë me anën formale të saj, por fakti i deklarimit në këtë deklaratë të këtij raporti, duket që ka pasur për qëllim të përshkruajë për efekt të kontrollit të pasurisë faktin se zotërimi mbi këtë send, formalisht në pronësi të bashkëshortit të subjektit, kishte kaluar te motra e tij, duke evidentuar se ky ishte vullneti i titullarit të pronësisë në atë kohë. Në dritën e kësaj rrethane, pretendimi i subjektit se motra e bashkëshortit pagoi diferencën e mbetur të detyrimit ndaj shoqërisë, në këmbim të kalimit të këtyre të drejtave “de facto”, bëhet i besueshëm.

5.5 Krahas analizës së mësipërme, duhet të konsiderohet edhe e dhëna tjetër se, pas kalimit të dy viteve, në vitin 2012, motra e subjektit bëhet pronare formale e këtij automjeti nëpërmjet lidhjes së kontratës së shitblerjes mes saj dhe bashkëshortit të subjektit, duke konfirmuar vullnetin e palëve të paformalizuar, por të deklaruar si të tillë në deklaratën periodike të vitit 2010.

5.6 Përpos sa më sipër, vlera e përcaktuar në kontratën e shitjes së këtij automjeti, në vlerën 3000 euro, e shpjeguar nga subjekti se përfaqësonte diferencën e mbetur të çmimit të dakordësuar mes palëve, i jep kuptim financiar transaksionit të kryer mes bashkëshortit të subjektit dhe motrës së tij, duke qenë se çmimi i shitjes së këtij automjeti mes motrës dhe vëllait për një vlerë prej 7000 eurosh, ndërkohë që ishte kontraktuar në vlerën 10.000 euro me shoqërinë *leasing* dhe ishte përdorur 2 vjet prej bashkëshortit të subjektit, duket si një marrëveshje e arsyeshme financiare, konsideruar edhe marrëdhënien e posaçme familjare.

5.7 Krahas këtyre elementeve, renditet edhe e dhëna tjetër që përftohet nga informacioni bankar i Bankës Credins se në datën 14.07.2010, motra e bashkëshortit të subjektit ka përfituar një kredi në vlerën 4000 euro, ndërkohë që pagesa e shumës prej 5210 eurosh është bërë nga bashkëshorti i subjektit në datën 12.07.2010. Ndonëse data e disbursimit të kredisë është dy ditë pas pagimit të këstit për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë Tirana Leasing, ky spostim në kohë, i cili mund të justifikohet edhe nëpërmjet administrimit apo përdorimit krejt të përkohshëm dhe imediat të vlerave monetare të tjera, të cilat për shkak të kohës shumë të shkurtër nuk marrin relevancë në trajtimin e kësaj çështjeje, nuk e zbeh gjithsesi shpjegimin e subjektit se kjo vlerë bashkë me diferencën prej 1000 eurosh, kursime të motrës së subjektit, është përdorur për të paguar detyrimin e cituar më lart.

5.8 Për të gjitha sa u arsyetua më lart, bazuar në analizën e orientuar prej nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, kam arritur në konkluzionin se këto deklaratime të subjektit janë bindëse dhe se ky konkluzion duhej të kishte afektuar analizën financiare të kryer për të kontrolluar burimet e ligjshme të përdorura për krijimin e pasurive e përballimin e shpenzimeve, duke zbritur nga vlera prej -970.609 lekësh, të cilat kishin rezultuar sipas Komisionit⁸ si bilanc negativ par vitin 2010, vlerën prej 5210 eurosh, e konvertuar në 792.834 lekë, veprim i cili do të prodhonte një balancë negative shumë më të ulët, në vlerën prej 177.775 lekë.

5.9 Në konkluzion të kësaj çështjeje, kam vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë në deklaratën *vetting* duke mos deklaruar burimin e krijimit të pasurisë automjet të markës “Hyundai”, sipas kriterëve të parashikuara në shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, në mënyrë të plotë e të saktë, por kjo pasaktësi nuk mund të konsiderohet se ka peshën për t’u ngritur në nivelin e një shkakut shkarkimi.

6. Në lidhje me analizën financiare, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, rezulton me vite në të cilat bilanci është negativ, duke përdorur përfundimet e mësipërme, situata e saj financiare nuk do të ishte si ajo e përshkruar në vendimin e Komisionit, sepse viti 2007 do të kishte një balancë pozitive duke përdorur si vlerë të pasurisë apartament, vlerën 70.000 euro; viti 2010 do të kishte një balancë negative në vlerën prej 177.775 lekësh, ndërsa për vitet e tjera sipas analizës financiare të kryer në Komision e të konfirmuar në Kolegj, do të kishte respektivisht, në vitin 2011 mungesë në vlerën 183.362 lekë; në vitin 2014 mungesë në vlerën prej 106.009 lekësh; në vitin 2015 mungesë në vlerën 101.180 lekë. Në total, subjekti do të kishte një bilanc negativ për të gjitha vitet e nënshtruara kontrollit të pasurisë në vlerën 568.326 lekë.

6.1 Për të vlerësuar, në zbatim të parimit të shqyrtimit të çështjes sipas parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nëse kjo diferencë negative në gjithë këto vite të analizuara

⁸ Shih analizën në faqen 19 të vendimit të Komisionit.

të subjektit të rivlerësimit do të përbëjë ose jo një mungesë të burimeve financiare të tillë që të shërbejë për të kualifikuar se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duhen mbajtur në konsideratë disa faktorë.

Së pari, vlera e balancës negative të llogaritur si më lart, është një vlerë jo e konsiderueshme dhe rezultat i një analize me elemente subjektive brenda saj dhe përdorimin e disa të dhënave të mbështetura në vlerësime e supozime apo standarde ligjore, të cilat kanë gjithsesi një dozë pasaktësie në vetvete⁹.

Së dyti, këto diferenca janë të shpërndara në katër vite duke prodhuar diferenca negative në vitet përkatëse në vlera të vogla e jodomethënëse, për të treguar nivelin e ligjshmërisë së burimeve të subjektit.

Së treti, subjekti i rivlerësimit ka në pronësi të saj dhe të bashkëshortit dy pasuritë e analizuara më sipër, që konsistojnë në një apartament me sipërfaqe prej 85 m² dhe një automjet të markës “Hyundai”. Të dyja këto pasuri përfaqësojnë sende në vlera të arsyeshme, konsideruar statusin social dhe pasuror të subjektit dhe të përfituara për të plotësuar nevojat jetike të familjes së saj. Të drejtat e pronësisë mbi këto pasuri tregojnë për një qasje modeste dhe të arsyeshme drejt sigurimit të kushteve normale për jetesë, pa shfaqje të tendencës për një jetë luksi apo të orientuar drejt shpenzimeve të tepruara.

Së katërti, të dyja këto pasuri janë krijuar prej subjektit e bashkëshortit në një periudhë kohe kur subjekti i rivlerësimit nuk ishte pjesë e sistemit gjyqësor, për pasojë krijimi i burimeve të tyre del në këtë sens nga mundësia e përdorimit të përfitimeve të paligjshme, për shkak të ushtrimit të funksionit të magjistratit, duke iu larguar disi qëllimit të miratimit të reformës në drejtësisë.

6.2 Për të gjitha sa kam arsyetuar më lart, kam vlerësuar në përfundim se pasaktësia në deklarime në deklaratën *vetting*, së bashku me vlerën e bilancit negativ për shumën e cituar, nuk duhen konsideruar si elemente që cenojnë standardin kushtetues të “provimit bindshëm” të burimeve të ligjshme të pasurisë e vërtetësisë së deklarimeve për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, dhe se ajo nuk gjendet në situatat e parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe as nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, për pasojë ajo duhet të konsiderohet se e ka kaluar testin e kontrollit të pasurisë, duke arritur një nivel të besueshëm në lidhje me të, në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

6.3 Për sa kohë që për dy kriteret e tjera edhe Komisioni ka konkluduar se është arritur niveli i besueshëm që kërkon neni 59, pika 1, germat “b” e “c”, vendimi i Komisionit që ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit duhej të ndryshohej në bazë të nenit 66, pika 1, germa “b” e subjektit i rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, të konfirmohej në detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

⁹ *Shih vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019; nr. 3/2020 (JR), datë 04.03.2020; nr. 24/2020 (JR), datë 30.09.2020; nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020.*